

ALEKSANDËR BOJAXHI

UNË

Alpinisti Trajner

Kujtime nga veprimtari të natyrës alpinistike

(1962–1992)

Autor:
Aleksandër Bojaxhi

Titulli:
UNË Alpinisti Trajner
Kujtime nga veprimtari të natyrës alpinistike (1962-1992)

Redator:
Dorina Mosku, Bledi Preza, Menduh Zavalani, Anila Isaku (Gjokoreci)

Paraqitja grafike:
Elvis Bejtja

Fotografitë në kopertinë:
Vasil Stambuli
Zenel Kokomiri

HYRJE

Kujtimet në faqet që do vijojnë janë copëza nga jeta ime alpinistike, si edhe veprimtari të lidhura me të. Me ndonjë përjashtim këto nuk janë përfshirë në botimin “Nëpër Bjeshkët e Namuna”.

Këto kujtime përfshijnë pjesën e parë të jetës time si alpinist dhe si trajner e cila tregon për periudhën nga janari i vitit 1962 deri në qershor të vitit 1991.

Sa më poshtë i kam shkruar për të kujtuar kohën time dhe kohën e bashkëmoshatarëve të mi të jetës alpinistike. Sigurisht, sa do të lexoni janë njëra anë e jetës alpinistike, më së shumti ana e “teknikaliteteve” në lëvizjen alpinistike. Mendova t’i hedh në letër, që një ditë nëse do të shkruhet një histori për sportin e alpinizmit, këto shënime të ndihmojë sadopak histori-shkruesin.

Autori

Klubi Sportiv Studenti

Në fund të muajit Janar 1962, pikërisht kur fillonin pushimet dimërore studentore, rastësisht u njoha me mundësinë që si student të shkoja për pushime në kamp, me fletë kampi, në malin e Dajtit, përkundrejt një pagese të arësyeshme. Kur arrita atje, u habita që aty mësohej alpinizmi. Gjithëshka që kalova në këtë kamp më dha një përjetim të këndshëm, të cilin nuk e dija dhe nuk mendoja se do ishte një kënaqësi e dashuri për natyrën dhe lirinë që të japin lartësitë, e që do më shoqëronte përgjithmonë.

Nga gjërat që më mbetën në mendje lidhur me individë të caktuar, e që u lidhën me jetën time alpinistike të mëtejshme, ishin tri:

Një ndodhi “alpinistike” me një grup studentësh alpinistë të drejtuar nga Vasil Stambuli, të cilët vajtën për një ngjitje në pjesën “prapa” malit të Dajtit dhe që krijuan shqetësime për vonesën e kthimit. Kjo ngjitje e veçantë, të cilën e drejtoi vetë Vasili, ishte në kuadrin e ngjitjeve që duhej të bënte ai që të plotësonte edhe kushtin e fundit për të marrë titullin Mjeshtër Sporti.

Në kamp një togë me studentë drejtohej nga Petraq Kule, i cili ndonëse ishte mjeshër (zdrukhtar) në Berat, ishte thirrur për të dhënë ndihmesën e tij si instruktor. Drejtues togash (instruktorë) ishin edhe Kozma Grillo, Mustafa Selenica, Andon Tapia, etj.

Ishte “pranuar” në kamp Qazim Loço, i cili me rekomandim të Luigj Shalës ishte përfshirë nga Minella Kapo, drejtues në këtë veprimtari, në një nga togat në të cilat organizohej stërvitja alpinistike e studentëve. Qazimi konsiderohej si nxënës-alpinist i Luigj Shalës, i cili shquhej në grupin e tij dhe që shihej me të ardhme si alpinist.

Gjatë ditëve të qëndrimit në mal mësova edhe se jo më shumë se 10 ditë pasi të largoheshim nga mali i Dajtit do të organizohej ngjitje në majën më të lartë të malit të Tomorit. Mirëpo, meqënëse në Dajt shkohej duke paguar atë që atëherë quhej “fletë kampi”, por edhe meqë ky argëtim për mua ishte tejet i këndëshëm, nuk më shkonte mendja se në malin Tomor shkohej pa paguar (d.m.th se shkohej me “dietë sportive”). Familja ime në ato kohë ishte aq ngushtë nga ana financiare, sa që t’i kërokja lekë për të vajtur në Tomor nuk bëhej fjalë dhe unë as që iu afrova rregjistrimit për të vajtur atje.


Kur erdhi stina e verës së po atij viti, isha i përfshirë në ekipin “Studenti” të atletikës dhe pata filluar stërvitje të rregullta për garat 800 dhe 1.500 metra. Fakti që në fshatin Theth zhvillohej veprimtari alpinistike e sezonit veror, e ngjashme me atë që pata kaluar në Dajt, ishte ende i panjohur për mua.

Në pushimet dimërore të vitit 1963 u gjenda përsëri në Dajt; këtë radhë në një dhomë me Genc Kurti, Xhevdet Harasani, Vangjush Gollosi, Faik Shorofi (këta nga fakulteti i mjeksisë) dhe Stefan (Pllaton) Grillo nga fakulteti i inxhinierisë. Ishim një

dhomë me studentë që shpejt u bë e lakmuar për shoqërinë tonë studentore aty, si dhe për kushtet e jetesës që krijuam në të. Gjatë kohës që ishim studentë ne formonim më të shumtën e ekipit në ngjitjet që u kryen në malet Tomor, Korab, etj. Shoqërinë që krijuam e ruajtëm (e ruajmë edhe sot, ne që jetojmë) edhe kur zbritëm nga Dajti. Këtë dimër, sikundër ishte rregulli, ne që kishim qenë edhe më parë në kursin alpinistik në malin e Dajtit, na futën në atë që quhej “toga speciale” dhe që sigurisht mësonim e kryenim veprimtari disi më të vështira alpinistike. Drejtues i togës sonë ishte Vasil Vreto dhe njohja me të në malin e Dajtit ishte një shans i madh për jetën time alpinistike të mëtejshme.

Në mbarim të sezonit stërvitor (quhej Zbor Alpinistik. Fjala zbor në gjuhën ruse ka kuptimin e “të qenit bashkë”, “të mbledhurit bashkërisht”; në këtë rast për të mësuar për alpinizmin) ne që ishim në togën speciale morrëm dëshminë “Kandidat Instruktor i Ri”. Një vit më parë na patën dhanë dëshminë “Alpinist i Ri”.

Gjatë ditëve të stërvitjes në Dajt, vendosëm të shkojmë në ngjitjen që organizohej për çdo vit (prej disa vitesh) më 23 Shkurt (dita e festës së Ushtrisë së Kuqe, emër ky i ushtrisë së ish-Bashkimit Sovjetik) ngjitja në majën e malit të Tomorit. Në përbërje të grupit ishim: Stefan Grillo (drejtuesi ynë), Genc Kurti, Qazim Liço, Xhovan Kajana dhe unë. Ishte dimër me shumë rreshje dhe ditën që u nisëm binte shi. Me autobus të linjës vajtëm në Gramsh. Në hyje të qytetit duhej të kalohej lumi-përrua i Holtës, jo i madh, por që atë ditë kishte prurje të madhe. Të gjithë zbritëm nga autobusi dhe pasi përveshëm pantallonat dhe hoqëm këpucët, sikundër edhe të tjerët, kaluam lumin dhe u ndalëm në lulishten e qytetit për të ndrequr barrën



Në mbyllje të vitit të dytë të shkollës së alpinizmit në malin e Dajtit alpinistit pjesëmarrësi i jepej titulli "Kandidat Instruktur i Ri"

e rancave tanë. Prej aty, nëpër një pasarele që ishte në ndërtim e sipër, kaluam lumin Devoll dhe morëm rrugën për në fshatin

Gjatë udhëtimit
nga Gramshi në
fshatin Kushovë
përrejtë e shumë
që kaluam
bënë që ne të
udhëtonim zbathur



Dardhë, por ndalua dhe kaluam natën në fshatin Kushovë, në një familje të atij fshati. Rrugës kaluam aq shumë përrenj me ujë të shumë, sa erdhi një moment që nuk ia vlente të vije e të hiqje këpucët dhe kjo bëri që një pjesë të mirë të udhëtimit ta bëjmë zbathur.

Të nesërmen u nisëm për në fshatin Dardhë dhe prej atje drejtpërdrejt për në majën e Tomorit. Kishte shumë borë, borë që nuk „të mbante“, dhe për arsye se ishim të ngurtë me rregullat që na kishin mësuar, kur vajti ora 14:00, pa e arritur majën, u kthyem dhe pas dy ditësh arritëm në Berat (ecëm më këmbë deri në fshatin Uznovë ngase nuk gjendej makinë).

Bora e rënë ishte
e madhe dhe
temperaturat ishin
të pamjafteshme
që ajo të kthehej
në borë të ngrirë




Në stinën e verës 1963 Dekanati i fakultetit tim, sipas programit, më caktoi, sikundër studentët e tjerë, që të bëj “punë fizike” në administratë ndërkohë që në atë periudhë kryhej veprimtaria alpinistike në fshatin Theth. Isha ende i “pamësuar” (por edhe natyrë shumë e drojtur) me rregullat e jo rregullat dhe kur më vonë mora vesh se Katedra e Fizikulturës së universitetit kishte të drejtë që të më përjashtonte nga puna fizike e të më dërgonte, për ekuivalencë të kryerjes së saj, në Theth (madje me dieta) më erdhi shumë keq. Por pas kësaj vere, ndonëse ende natyrë shumë e ndrojtur, kisha fituar aq përvojë sa të mos humbisja më veprimtaritë alpinistike që zhvillonte Katedra e Fizikulturës së universitetit tonë, e vetmja aso kohe që kishte ekip alpinistësh në vendin tonë.

Me fillimin e vitit akademik 1963- '64, një pasdite teksa stërviteshim ne studentët “alpinistë” të rinj, më thërret Minella Kapo (në atë kohë Shef i Katedrës së Fizikulturës së Universitetit të Tiranës dhe njëherësh alpinist me emër për kohën), në një nga “zyrat” e palestrës universitare dhe më njofton se më ka caktuar përgjegjës për stërvitjen e grupit të alpinistëve. Ky grup nuk ishte gjë tjetër veçse një bërthamë e gjashtëshes së dhomës sonë në Kampin e Dajtit, si edhe ndonjë student tjetër që hera herës bashkohej me ne e që merrte pjesë në veprimtaritë alpinistike. Në fakt unë u bëra përgjegjës “pa përgjegjësi” dhe ndërkohë vazhdoja edhe stërvitjet në atletikë 2-3 herë në javë, krahas stërvitjeve me shokët e alpinizmit 2 herë në javë. Stërvitja jonë përmbante vrapime, pasuar me grupe ushtrimesh si edhe më së shumti, në mbyllje, lojë me top.

Dimri i vitit 1964 ishte i fundit që shkova në Dajt. Ishim të njëjtët shokë (me përjashtim të Faik Sharofit që nuk erdhi dhe vendin e tij në dhomë ia dhamë Alfons Gurashit) dhe në të njëjtën

dhomë të godinës së kampit sikundër një vit më parë. Këtë radhë m'u dha një togë për ta drejtuar (drejtuesi quhej Komandant Toge) dhe në fund të veprimtarisë m'u dha edhe një diplomë që më dëshmonte dhënien e titullit "Instruktor i Alpinizmit."



Në mbyllje të vitit të tretë të shkollës së alpinizmit në malin e Dajtit alpinistit pjesëmarrës i jepej titulli "Instruktor i Ri"

Vera e vitit 1964 ishte një kohë që për mua ishte dhe mbeti e veçantë. Minella Kapo donte që të bënte realitet njohjen sa më të plotë të Alpeve tona (Bjeshkëve të Namuna) në drejtim të vlerave alpinistike dhe për këtë organizoi një ekspeditë me alpinistë. Kishte ftuar për të marrë pjesë të gjithë alpinistët më në zë të kohës, por edhe nga ne studentët që na mendonte si të rinj me të ardhme në alpinizëm: Mihal Bozdo, Genc Kurti dhe unë. Nga “çunat e Luigjit” mundi të vijë vetëm Astrit Omeri. Për arsye pune nuk erdhën në këtë ekspeditë alpinistë me emër të kohës si Tefta Zguro, Kozma Grillo, Vasil Stambuli, Koço Qafëzezi, Mustafa Selenica, Petraq Kule, e ndonjë tjetër.

Për t’u përgatitur për veprimtarinë për 3-4 javë patëm edhe stërvitje në palestrën universitare dhe qendrën stërvitore të studentëve (pjesë e atij territori sot është kryesisht Pallati i Kongreseve). Krahës ushtrimeve të ndryshme, vend të veçantë zunë kacavarjet në muret rrotull si edhe zbritjet me litar me metodën dylfer, e vetmja metodë zbritjeje me litar që njihej nga ne n’atë kohë. Pika kulmore e stërvitjes për mua, ato ditë, ishte zbritja dylfer nga tarraca e tribunës qendrore të stadiumit Kombëtar “Qemal Stafa” në pistë! Madje, kushdo atlet që stërvitej n’ato momente në stadium, ndalte stërvitjen dhe ndiqte zbritjet tona nëpërmjet litarit.

Ditën kur arritëm në Shkodër, u takuam edhe me alpinistët që mundën të vijnë nga rrethet. Minella na ndau në grupe nga tre vetë, sikundër do të ishim të organizuar në mal, për t’u plotësuar me ushqime si dhe për të kryer disa detyra kolektive që lidheshin me ekspeditën. Unë e Genci formonim një grup me dy vetë, në pritje të Vasil Vretos për të formuar treshen. U shpërndamë dhe mua m’u caktua si detyrë kolektive që të

siguroja në parkun e kamionëve të qytetit një mjet, për të gjithë ne, për të udhëtuar për tek Fusha e Zezë në Razëm. Me ndihmën e Gjon Simonit, atëherë edhe alpinist i qytetit të Shkodrës, nga telefonata e bërë parkut, administrata atje kërkoi që të paraqiteshim në orën 15:00. Pasdite me mua u bashkua edhe Minella dhe pasi morëm nga një biçikletë me qera, u nisëm për në park. Rrugës Minella më thotë se meqë Vasili nuk erdhi (me autobuzin e orës 14:00), unë e Genci do të mbeteshim një grup me dy vetë dhe unë do isha përgjegjës grupi. Mbaj mend se ky komunikim më erdhi aq i papritur dhe aq i padëshiruar sa për pak rashë nga biçikleta: atëherë nuk kisha përvojë shkëmbi dhe Minella, për mua, ishte i ngutur në këtë vendim. Mirëpo fati im i mirë donte që kur arritëm në hotel, pasi lamë administratën e parkut me premtimin për t'u nisur me kamion të nesërmen në mëngjes, Vasili kishte arritur!

Të nesërmen u nisëm dhe kamioni që do të ngarkohej me dru na la në Razëm tek Fusha e Zezë. Atje duhej të na priste dikush nga shërbimi kufitar me mushkat e tyre për ngarkesat/rancat tona të mbushura për mushka, por kjo nuk ndodhi. Në ato vite nuk kishte bujtina, dyqane, lokale apo restorante në fshatra dhe ne ishim përgatitur për të patur ushqime për rreth dy javë. Buka ishte problem i madh (ne shqiptarët edhe bukën e hamë me bukë!). Pritëm deri sa u bindëm se nuk do vinte kush me mushka dhe pastaj hodhëm ngarkesat në shpinë. Pas rreth tetë orësh udhëtim, gati në muzg, arritëm të rraskapitur në fshatin Brojë. Nderim të veçantë për ne bëri një djalë, i takuar rastësisht, i cili ishte kryetari i rinisë së fshatit. Ai na mori të gjithë ne në shtëpinë e tij për të kaluar natën. Ai bëri të pamundurën gjatë orëve të para të natës dhe siguroi mushka për ngarkesat tona

Në fshatin Brojë
bashkë me Genc
Kurtin duke
ngarkuar kalin që
do na transportonte
materialet deri në
Vermosh



për udhëtimin tonë deri në Vermosh. Më ka mbetur i paharruar premtimi, apo betimi, i tij sipas rasteve të komunikimit: “për parti e për pereni”.

U nisëm nga Broja me ngarkesat në mushka dhe kuaj dhe u ndalëm pak në Tamarë. U lamë në Lumin e Cemit. U mblodhën shumë nga rinia e fshatit; djem e vajza. Asnjë nuk u hodh në lumë që të na shoqëronte. Më pas udhëtuam përsëri dhe pasi fjetëm edhe një natë diku në Javore, mbasditen e ditës së tretë pasi kishim lënë Shkodrën, arritëm në qendrën e Vermoshit.



Një pushim tek një
burim gjatë udhëtimit
për në Vermosh.
Poshtë: Vangjel Ristani
dhe Xhelil Bakiri. Sipër:
Vangjel Melëngy, Vasil
Vreto, Aleksandër
Bojaxhi, Grigor Perikliu

Në Vermosh u hodh short për t'u ndarë në katër zona dhe sipas shortit Minella Kapo, Gregor Perikliu dhe Astrit Omeri u vendosën në pjesën më veriore, në Seferçe; Vangjel Melëngu, Vangjel Ristani dhe Xhelil Bakiri u vendosën në pjesën perëndimore të Vermoshit; Andon Tapia, Taxhedin Shehu e Mihal Bozdo u vendosën në pjesën Lindore të Vermoshit. Grupi ynë ishte në qendër të tre grupeve dhe do të përdornim dhomën e mësuesve të Vermoshit për jetesë dhe për fjetje.

Në qendër fshati kishte edhe një fushë futbollit e cila kishte pjerrësi nga porta në portë. Pasdite vonë organizuam një ndeshje futbollit me djemtë e fshatit. Ata e luanin futbollin në mënyrën “o topin o këmbën”, gjë që bëri që të tolerojmë dhe t'u mundësojmë fitoren 4 me 3. Asokohe, shkolla e Vermoshit ishte shkollë verore dhe viti shkollor punonte me kalendarin Mars –



Pjesëtarët e ekspeditës: (L) Astrit Omeri, Xhelil Bakiri, Minella Kapo, Vangje Mëlëngu, Vangjel Ristani, Grigor Perikliu (në mes) Genc Kurti, Vasil Vreto, Aleksandër Bojaxhi (P) Mihal Bozdo, Andon Tapia, Taxhedin Shehu

Dhjetor. Në ditët e qëndrimit tonë atje, shkolla dhe mësuesit kishin pushimet semestrale.

Pasi kryem 4-5 ngjitje, kryesisht shkëmbore (kacavarje), nga secili grup, ditën e fundit të qëndrimit atje, të gjithë ne bashkë me të rinj të fshatit u ngjitëm në majën e Marlulës. Pastaj u mbledhëm dhe diskutuam për vlerat alpinistike të zonës. Rezultoi se zona qendrore ku ishte grupi im kishte më shumë mundësi për kacavarje shkëmbore (kryesisht Kërshi i Djegun), por e përgjithshmeja e vlerësimit ishte: Vermoshi është vend shumë i bukur turistik, por me pak vlera për kacavarje e veprimtari cilësore alpinistike.

Pas Vermoshit i vinte radha për t'u studjuar territori në jug të tij. Ndarja e grupeve në zona u bë duke marrë parasysh kushtet e jetesës që përjetuam në Vermosh: grupi ku isha unë pati kushte të "privileguara" jetese në krahasim me grupet e tjera, andaj ne u caktuam në zonën që mendohej më e vështira për kushte

jetese, atë përtej Qafë Pejës, pranë dhe përreth Postës Kufitare Verore. Grupi i Minellës në Qafë të Dobraçës dhe dy grupet e tjera në zonat Nikç e Vukël.

Nga ngjitjet e kryera rezultoi se grupi im “ra” në thesarin e itenerareve për kacavarje shkëmbore. Kreshta Maja e Prozhmit - Maja e Lakojve – Kullat e Nikvaçit e deri në kufi ishte një stadium alpin praktikisht me mundësi të pafundme itenerarësh për kacavarje. Ky ishte përfundimi që doli edhe nga analiza përfundimtare e veprimtarive që kryem dhe që e organizuam në Theth.

Gjatë qëndrimit dhe diskutimeve në Theth mësova se alpinistëve nuk u jepeshin vetëm tituj sportivë (sikundër e mësova nga rasti i veprimtarisë në malin e Dajtit për Vasil Stambulin), por edhe kategori sportive (egzistonte tabela e Klasifikimit Unik Sportiv edhe për sportin e alpinizmit) dhe për rastin unë e Genci, morëm kategorinë e dytë sportive si alpinistë. Në muajin qershor ishte krijuar Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar dhe kategoritë sportive e diplomat na u shpërndanë në Tiranë nga shoqata në mënyrë solemne. Në ceremoni mori pjesë edhe Vasil Konomi, atëherë Kryetar i Komitetit të Këshillit të përgjithshëm të BFSSH-së.

Për mendimin tim Vasil Vreto ishte një kacavarës i lindur. Më vonë bëra ngjitje me të edhe në veprimtari të tjera dhe për mua ai ishte kacavarësi më i mirë i kohës. Fakti që ishte caktuar për të shkuar me ekipin Shqiptar për kacavarje shkëmbore në Gjermaninë Lindore më 1960 duket se ishte pikërisht aftësia e tij e lindur si kacavarës. Vasili në këtë veprimtari u bë mësuesi im i madh i kacavarjes.

Grupi ynë në këtë veprimtari realizoi më shumë ngjitje se çdo grup tjetër, si në sasi edhe në vështirësi, dhe kjo mbi të



Në mbyllje të veprimtarisë unë dhe Genci realizuam kërkesat
për marrjen e kategorisë së dytë sportive



Aleksandri, Vasili dhe Genci. Në sfond "stadiumi" i itinerarëve alpinë pranë majës së Lakojve

gjitha ndodhi falë shortit që na ra në të dy etapat e ekspeditës. Në grupin tonë gjatë kacavarjes, në litar gjithnjë ishte Vasili i pari, Genci i dyti dhe unë në fund. Kjo sepse, si unë edhe Genci, nuk kishim zemër të udhëhiqim. Por në ditën e fundit të veprimtarisë Vasili na nxiti që ne ta udhëhiqim kacavarjen për në Sqeta e Cjapit. Itenerari që morëm ishte një pllakë shkëmbore, më e majta tek e sheh majën nga vendi i ngritjes së tendave. Unë udhëhoqa gjysmën e parë të itinerarit dhe Genci gjysmën e dytë. Ndjeva një kënaqësi të pamatë tek udhëhoqa, aq sa që nga ajo ditë udhëheqja e itinerarit të kacavarjes dhe kacavarja e itinerarëve të pa realizuar më parë u bënë dëshira ime më e parë në veprimtaritë në male.

Në veprimtarinë kombëtare të kacavarjeve që u krye në verën e vitit 1965 dy grupe alpinistësh të drejtuara nga Kozma Grillo e Petraq Kuli kryen nga një javë kacavarje (duke u këmbyer zonat pas shtatë ditësh) në zonën rreth Postës Kufitare Verore dhe

në Qafë Dobraçe, por më pas, për disa vjet, kacavarjet cilësore shkëmbore u kryen thujse vetëm në zonën rreth Postës Verore (kampet ngriheshin mbi Fushë Runicë, pranë burimit të quajtur Sheu i Bardhë (ndoshta ngaqë aty kishte gjithnjë borë). Që nga ajo kohë kjo pjesë e Alpeve, nga ne alpinistët, më së shumti u quajt Posta Verore (këtu shpërngulej posta kufitare e Thethit gjatë periudhës së ngrohtë të vitit). Koha dhe ngjitjet e kryera na mësuan se vend i përshtatëshëm për ngritjen e fushimeve për kacavarje ishte edhe vendi i quajtur Kllogje.

Më 1965, në një kacavarje ku më kishin caktuar të ngjitesha duke filluar nga Dobraça në rrëzë të Majës së Madhe (Shnik) me dy alpinistë nga Vlora, ai që ishte i dyti në litar (nuk ia mbaj mend emrin asnjërit prej tyre), mbasi kisha ngjitur litarin e parë (gati 40 m vetëm vertikalisht), duke parë vështirësitë e kaluara u tremb dhe u zgjidh nga litari duke e braktisur ngjitjen. Ngela sipër por jo i braktisur nga alpinisti tjetër, i cili tutej të më ndiqte. Kur po diskutoja me partnerin e mbetur që të zbrisja, ndërhyri Myftar Marku (kishte ardhur në veprimtari si i dërguar i Shoqatës sonë) i cili kaloi aty pari dhe e pa atë që ndodhi. Ai e bindi partnerin tim që të më ndiqte dhe kështu ngjitja vazhdoi deri sa arritëm të dy në majë të Majës së Madhe. Ky ishte dhe mbeti itenerari më interesant e më cilësor që kam ngjitur në këtë mal.

Klubi Sportiv Apollonia

Në Qershor të vitit 1965 u diplomova nga Universiteti i Tiranës si “Mësues i Fizikës për Shkollën e Mesme” (në jetën si mësues m’u desh të jepja më së shumti lëndën e matematikës) dhe viti shkollor 1965-66 më gjeti me emërim në detyrë mësues në gjimnazin e qytetit Patosi i Ri (Rrethi i Fierit). Fieri nuk kishte ekip alpinistësh, kështu që në veprimtaritë kombëtare alpinistike për ca kohë shkova herë si alpinist i Klubit Sportiv Studenti dhe herë me dieta nga Shoqata.

Ndërkohë Klubit Sportiv Aplollonia iu rekomandua nga Sekretari i Shoqatës së Alpinizmit, Muharrem Sinoimeri, që unë të përkrahesha për të krijuar një ekip alpinistësh aty. Përkrahja nga drejtuesit e klubit fillimisht ishte sa për sy e faqe dhe në veprimtaritë e para ku filluam të përfaqësojmë këtë klub, unë merrja pjesë si ekipi Apollonia me sportistë të sporteve të tjera të këtij klubi që më jepeshin nga drejtuesit për të “krijuar” ekipin. Kjo sepse, dukej që nga një anë ata nuk kishin besim tek unë, por nga ana tjetër e shihnin normale që sportistët cilësorë të ekipeve që kishte klubi të vinin me mua në mal për të patur një veprimtari e trajtim suplementar nga ai që ata kishin në ekipet e

Në Shkodër para nisjes
për në veprimtari:
Kleanthi Dapi,
Aleksandër Bojaxhi,
Reiz Rapaj dhe Kujtim
Mustafa (sipër)



tyre përkatëse. Por kishte edhe të rinj që iu bashkuan ekipit për t'u bërë një ditë anëtarë të rregullt të ekipi Apollonia. Ata morën pjesë në ngjitje të organizuara në malin Tomor, në Malin Guri i Topit, etj.

Kjo gjendje vazhdoi për dy vitet e para të qëndrimit tim atje dhe kthesa ndodhi më vitin 1968, vit kur m'u la dorë e lirë që të bëja atë që mendoja e dëshiroja unë për të formësuar ekipin e alpinistëve. Për këtë kam falenderuar me veten gjithnjë Pipi Natin, Pipi Janin e Ali Demën, persona që asokohe ishin vendimarrës në Klubin Apollonia. Por edhe Vasil Lulon, magazinierin, i cili ishte shumë i kujdesshëm dhe besnik me mua që materialet e siguruar me vështirësi të ekipit tonë, të lakmuara nga shumëkush, të mos përdreshin nga individë ose ekipe të tjera.



Foto e veçantë e shkrehur gjatë një pushimi në veprimtarinë për ngjitjen e majës Guri Topit, 1967



Ekipi Apollonia në shkollën e alpinizmit në Theth, korrik 1968



Kreshta e mali të Tomorit nga jugu në veri. Fotografuar nga Aurel Duka

Në Dhjetor 1968, me një ekip të vërtetë alpinistësh, të veshur e të mbathur më mirë se cilido ekip për kohën, vendosa të realizoj kalimin e kreshtës së malit të Tomorit: kalimin nga maja e Kulmakut në majën e Tomorit.

Edhe diçka tjetër: ideja e kalimit të kreshtave, apo realizimi i ngjitjeve përgjatë kreshtave, nuk e mbaj mend se si e nga më erdhi, por mbaj mend se n'atë kohë nuk më pëlqente që veprimtaritë tona ishin kryesisht të llojit “ngjitja e një maje mali.” Kështu p.sh. në dimrin e vitit 1964 ne duhej të bënim në këmbë udhëtimin Bogë-Shtegu i Dhenve-Theth- maja e Popllukës-Valbonë-Dragobi-Bajram Curri (n'atë kohë nuk ekzistonte rruga automobilistike Bajram Curri – Valbonë) dhe nga e gjithë kjo ngarkesë fizike tejet e lartë dilnim vetëm me ngjitjen e majës së Popllukës. Ishte një lodhje e madhe fizike për të ngjitur vetëm një majë. Më dukej si një mbartje e idesë



Thoma Stambuli, Aleksandër Bojaxhi, Nasi Shtëmbari, Petraq Rista në majën e Kulmakut – ndryshe Çuka e Tomorit - (e pagëzuar, me një ceremoni të organizuar në majë të malit nga alpinistat në vitin 1950, me emrin Çuka Partizane)

së marshimeve partizane gjatë L.II.B. Më ngjasonte edhe si një mundim për të ngjitur një majë 7-8000 metërshe dhe jo një mundim për lartësitë e maleve tanë. Duket se këto mendime gradualisht më sollën në idenë që më ndoqi për vite, e madje edhe sot jam për të, që ngjitjet dimërore të bëheshin duke i ngjitur majat nëpërmjet një udhëtimi që ndjek përafërsisht kreshtat e majave. Dhe prova e parë për mua duhej të ishte mali i Tomorit, kreshta e të cilit nuk është e gjatë.

Ishte vera e vitit 1968 koha kur në bisedë e sipër me Petraq Kulen mësova se ai me një grup të vogël alpinistësh nga Berati e kishte kryer kalimin e kreshtës së malit të Tomorit në dytri ditë vere. Si duket unë kaq doja. Interesimi im për pikat e “nxeha” të kreshtës bëri që Petraqi të më japë shpjegimet e

duhura dhe meqë e kisha realizuar veshjen e mbathjen e ekipit, mora vendimin që si ekip i vërtetë alpinistik “Apolonia” e Fierit të fillonim ngjitjet e pavrura nga ekipet e tjera me kreshtën e malit të Tomorit.

Arritëm të sigurojmë leje nga puna vetëm katër vetë: unë, Nasi Shtëmbari, Petraq Rista dhe Thoma Stambuli. Vija e borës fillonte në lartësinë 1800 metra dhe ne e arritëm me ditë majën e Kulmakut. Asokohe aty, në majë, shërbente një njësi ushtarake e ndërlidhjes dhe me atë njësi kaluam një orë të këndëshme me çaj e ushqim si dhe ngrohje në strehimin e tyre. Pas kësaj u ndamë me ta dhe morëm rrugën e kreshtës. Moti ishte me ne. Kujtoj se para ndarjes me ushtarakët pozuam dhe pas ndarjes ne udhëtuam ca. Me dritë ngritëm tendën për të kaluar natën. Ishte nata më e gjatë e vitit 1968: 22 Dhjetor.

Të nesërmen në mëngjes, pasi filluam udhëtimin, Petaq Ristës i futet këmba në një zgavër midis borës e shkëmbit dhe në një të dalë të shkëmbit aty brenda gropës dërrmon gjurin. Menduam



Një kujtim me anëtarët e njesisë ushtarake të ndërlidhjes

se nuk do të ishte gjë serioze, por brenda një kohe të shkurtër rezultoi se ai jo vetëm që nuk mund të vazhdonte më tej, por duhej edhe të ndihmohej për të ecur (çapitur). Atëherë morëm një vendim krejt të padëshiruar: të braktisnim itinerarin (qëllimin) dhe të uleshim poshtë. Vendimi ishte shumë i dhimshëm, por zbritja tregoi se morëm një vendim të drejtë.

Tek u ulëm, Petraqi na detyronte të ecnim ngadalë, dhe arritëm nën vijën e borës ishte gati në të errur. Tingujt e këmborëve të bagëtive na ndihmuam të gjejmë stanin dhe dy barinjtë e tij. Stani ishte një kasolle fare e vogël: vend për të fjetur dy vetë, ndërtuar me dru, me tre faqe të thurrura dhe një faqe, anë, të hapur. Jashtë pullazit të kasolles ishte ndezur zjarri. Me lejen e tyre ngritëm pak metra larg kacolles tendën tonë dhe menjëherë filluam përgatitjen e darkës. Pasi hëngrëm i pyetëm se mos kishin ndonjë cigare. Nuk kishin por u treguan shumë të përzemërt me mua dhe njëri prej tyre u tregua edhe i gatshëm për të vajtur në fshat që të blinte një paketë. Kur e mora vesh se fshati ishte dy orë larg, sikundër tha, refuzova të shkonte dhe i thashë se “nuk dua të më bëhet një nder të cilin, po të më vinte mua rasti, nuk do t’ua bëja të tjerëve”. Por ai ngulmoi e madje më tha se edhe sikur unë të jem duke fjetur ai do e sillte paketën që ta kisha për të nesërmen në mëngjes. Kundërshtia ime nuk ndikoi tek bujaria e tij e tepruar dhe ai na la dhe iku.

Pas pak unë e Petraqi u ngritëm nga zjarri dhe vajtëm për të fjetur duke lënë në bisedë Nasin, Thomain dhe bariun. Natën më doli gjumi: duhej të ishte shumë vonë dhe në tendë ende nuk kishin ardhur të dy shokët tanë, kurse pranë zjarrit vazhdonte biseda, madje dukej sikur ishin shumë vetë që bisedonin! U ktheva nga ana tjetër dhe vazhdova gjumin. Kur u ngrita në

mëngjes mësova nga dy shokët tanë (barinjtë ishin larguar me bagëtinë) se çfarë kishte ndodhur përgjatë natës.


Barinjtë kishin menduar se ne të katërt kishim dalë për diversion dhe kishim zgjedhur malin për t'u strehuar. Kërkesa për cigare i kishte dhënë mundësinë njërit prej tyre të justifikojë e të ulej në fshat ku kishte njoftuar oficerin operativ të zonës për dyshimin e tij. Oficeri kishte mobilizuar dy skuadra pushkatarësh dhe kështu mbi 15 vetë erdhën në mal, rrethuan në heshtje tendën dhe stanin dhe pas kësaj bariu me operativin dhe një i tretë erdhën tek zjarri. Biseda me miqtë e rinj shumë shpejt u ngrit në tone jo të përzemërta ngase operativi në një moment filloi detyrën e hetimit. Bisedat erdhën dhe u acaruan kur u shpreh dyshimi i vendasve ndaj nesh për diversantë dhe vetëm hollësitë që i dinte Nasi, si patosarak, për historinë e një djali nga ajo zonë e Skraparit, i cili kishte therrur një vajzë gjimnaziste nga Patosi e që gjykata e kishte dënuar me varje (në Patos), mundën ta bindin operativin se ne ishim qytetarë të thjeshtë e jo diversantë. Pas kësaj një fishkëllimë e tij kishte nxjerrë nga pozicionet ku ishin fshehur pjesën tjetër të pushkatarëve dhe të gjithë të mbledhur rreth zjarrit të bërë edhe më të madh vazhduan bisedat me tone miqësore deri në katër të mëngjesit.

Kisha hyrë në vitin e katërt që jepja mësim në një qytet ku dominonin punëtorë (naftëtarë) ndonëse aty ishte "armata" më e madhe e mundëshme, për një qytet, me intelektualë. Nga takimet me ta merrja shpesh mesazhe lidhur me mendësinë e tyre për jetën e shoqërinë dhe kisha krijuar bindjen se një shoqëri si e jona ka nevojë që kuadrot më të mira e shkollat më të mira t'i përqëndrojnë në zonat më të largëta dhe jo në qytete. Në mos, ne që e quajmë veten qytetarë të qytetëruar dhe që fizikisht e

shpirtërisht e ndërtojmë jetën me kulturën e kohës, gjithnjë do të ankohemi nga mendësia e shumicës së atyre që edukojmë dhe familjeve të tyre. Dhe sa herë që këto mendësi na shqetësojnë me ndërhyrje në jetën tonë, ne do i drejtohem kësaj kategorie shoqërore me nofka të tilla si fshatarët, katundarët, malësorët, malokët. Pra, gjithfarë epitetesh me të cilat ne shfryjmë ndaj tyre jo për vese, por për padijen që kanë dhe që tek e fundit jo vetëm që nuk ndreqim gjë, por me raste mund edhe të krijojmë një armiqësi të heshtur me ta. Fakti që katër të rinj vinë në një mal në fund të vitit 1968 për t'u argëtuar dhe që më pas vjen një fshat e i rrethon duke i paragjykuar për diversantë ishte ilustrimi më i mirë i ndeshjes së kulturave brenda kombit dhe të tilla kultura e minikultura ne kemi edhe brenda qyteteve e madje, me raste, edhe brenda komuniteteve. Mendoj se teoria dhe praktika e luftës së klasave që ushqente në shoqërinë tonë partia jonë e punës, vetëm sa e nxiste dhe e shëmtonte më shumë këtë dallim.

Në Patos jepja mësim edhe në gjimnaz, shkollë ku më vonë u shtuan edhe degë profesionale, edhe në shkollën e mesme profesionale të natës (shkollë pa shkëputje nga puna). Kjo më dha mundësi që të zgjedh djem nga gjimnazi të cilët kishin interes e dashuri për t'u argëtuar në natyrë. Pati prej tyre që kur shkuan studentë në Universitetin e Tiranës e ndoqën sportin e alpinizmit duke përfaqësuar Klubin Sportiv Studenti.

Me gjimnazistët organizonim ekskursione të ndryshme në natyrë dhe pjesëmarrja e nxënësve ishte shumë e mirë. Mbështetja dhe pjesëmarrja në këto veprimtari ishte shumë e mirë edhe nga mësuesit e edukimit fizik, si edhe nga mësues të tjerë të shkollës. Veprimtari kulmore të çdo viti kishim ngjitjen në malin e Shpiragut. Në muajin Shkurt, në fundjavën e hënës



Gjatë një ore mësimi në gjimnazin e qytetit Patos i Ri

së plotë, me nxënës nga maturat edhe me një pakicë nxënësish të zgjedhur nga klasa më të ulta, niseshim mbasdite nga Patosi. Udhëtonim për tërë natën dhe pasi pushonim në një pyll të dendur me shqopa, ku na mundësohej ndezja e zjarrit dhe mbrojtja nga era, në mëngjes, sapo zbardhte, gjendeshim në një shkollë rëzë Shpiragut. Prej këtu ngjiteshim në majë dhe shikonim lindjen e diellit në malin e Tomorit. Kthimi na merrte mbi tetë orë dhe në pasditen e vonë të së dielës arrinim në qytet. Ishte një ekskursion shumë i dëshiruar nga nxënësit dhe pasi e kryem vitin e parë, më vonë ishte “luftë” për të mos krijuar grup të një madhësie që ne mësuesit nuk do të mundej ta drejtonim të organizuar si duhej.

Në Shtëpinë e Pioneerit të qytetit të Fierit krijova një ekip turistik me nxënës të shkollave 8-vjeçare nga Fieri dhe nga

Një kujtim me
Vladimir Mane
në malin e Dajtit
në pushim të një
seminari



Patosi Ri. Kryenim veprimtari të rregullta dhe nxënësit e Patosit shkuan deri atje sa të organizonin veprimtari vetë, pa të rritur (kjo krijoi në një rast pështjellim të madh ndër prindër dhe në Komitetin e Partisë së qytetit). Ky ekip më vonë u drejtua nga Vangjel Zeno dhe nga Vladimir Mane, anëtarë të ekipit të parë, dhe një ditë nga radhët e tij dolën edhe të rinj që iu bashkëngjitën ekipit të alpinizmit.

Në Patos ekskursionet patën gjallëri e dükë, e dikur më thirrën në komitetin e rinisë dhe “më hoqën veshin” që unë nuk po i drejtoja ato, por këtë e bënin vetë të rinjtë (Komiteti i Rinisë

donte që dikush t'i drejtonte ngase për kohën partia duhej të kontrollonte gjithçka). Nuk mora përsipër asgjë dhe kjo bëri që të më shohin shtrembër. Mirëpo pas disa muajsh, veprimtaritë në natyrë nga rinia e Patosit u përfolën pozitivisht nga organi qëndror i rinisë në Tiranë dhe kjo bëri që shpejt edhe në Patos t'i shihnin këto veprimtari me sy të mirë.

Ndërkohë, thujse çdo mëngjes, dilja e zhvilloja fizikulturë (gjimnastikë) bashkë me Petraq Ristën, anëtar i ekipit të alpinistëve, dhe futbollistin e ekipit të futbollit Puntori i Patosit Shebedin Adili, e me raste prananim edhe ndonjë tjetër në grupin tonë. Dilnim nga fjetorja më pesë të mëngjesit dhe vraponim në rrethinat e qytetit. Ai qytet i vogël, ku përfolja ishte pjesë e jetës, shpejt mësoi se çfarë bënte “profesori” me disa shokë dhe pas disa muajsh të rinj të qytetit, më vete ose në grupe, filluan të bënin të njejtën gjë. Nga lartësia e kodrës ku çdo mëngjes ndalonim dhe kryenim cikle ushtrimesh, ndjenim kënaqësi tek shihnim se java-javës shtohesh numuri i “fizikulturistëve të mëngjesit.” Na vinte mirë që kishim ndikuar tek të rinjtë e atij qyteti që të bënin atë që bënim ne!

Në shkollën e mesme të natës pata rastin të përzgjedh për në ekipin alpinistik Apolonia djem që në karakter e moral të ishin pozitivë, por edhe me dëshirë për sport e për alpinizëm. Siguroja gjithnjë anëtarë ekipi që si njerëz ishin thjesht pozitivë në gjykimin tim, ngase fillimisht nuk dihej nëse ata do të bëheshin alpinistë. Stërvitjet si ekip i bënim kryesisht të karakterit fizik. Vendin e stërvitjes e kishim në luginën e bukur që të nxirrte nga pjesa veriore e shkollës së mesme (të kohës) tek rezervuari e në Patos Kantjer. Aty kishte forma relievi që ndihmonin përgatitjen fizike dhe mbi të gjitha ishte vend ku askush nuk të shqetësonte. Më vonë, me mbështetje të Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës



Ekipi Aplonia në shkollën e Alpinizmit në Theth. Në shkollat e alpinizmit, kudo që ato organizoheshin, më së shumti vinin alpinistë të rinj; por vinin edhe alpinistë me përvojë.

dhe personalisht të drejtuesit të saj Lipe Nashit, në kufijtë e gjimnazit dhe të stadiumit të qytetit u ndërtua për qytetin një kënd sportiv që ishte i rrallë në Shqipërinë e atyre viteve (por që kurrë nuk u nda fond për mirëmbajtjen e tij) dhe kështu ekipi ynë pati një shans të rrallë për mundësi thujtë të plota në përgatitjen fizike. Përgatitjen teknike dhe teorike (intelektuale) e realizoja nëpërmjet grumbullimit të ekipit para veprimtarive alpinistike, grumbullime këto që kryheshin në vende të ndryshme malore. Me raste organizonim veprimtari më vete (që quheshin të karakterit lokal dhe që ne i kryenim gjithnjë në zona malore jashtë rrethit të Fierit).

Me këtë ekip arrita të ngjitem në itinerarin veri-lindor të majës së Harapit, ngjitje të cilën e realizuam me Vangjel Zenon



Alpinistë kacavarës. Lart: Venigjar Velaj (Vlora), Gazmend Shaba (Partizani), Vangjel Zeno (Apollonia), Vullnet Zylyftari (Studenti). Poshtë: Nasi Shtëmbari (Apollonia), Aleksandër Bojaxhi (Apollonia)

e Nasi Shtëmbarin dhe ky i fundi na e udhëhoqi ngjtitjen në të katër litarët e vështirësisë. Realizimi i këtij itinerari nuk fliste pak për nivelin teknik të ekipit: ky itinerar për nga vështirësia

teknike qëndroi deri në fund të viteve 80-të kacavarja më e vështirë. Ky përfundim është dhënë edhe nga Ilir Tapia dhe Sokol Doko, dy alpinistë të ekipit të Tiranës, që kryen të gjitha ngjitjet e njohura në këtë majë duke përfshirë edhe ngjitjen e plotë të faqes jugore.

Viti 1969 ishte i veçantë për mua në aspektin sportiv. Në verën e këtij viti, në muajin korrik, gjatë ditëve të shkollës së alpinizmit aty mua mu akordua titulli “Mjeshtër Sporti”.

Në muajin nëntor të këtij viti u organizua Ekspedita Alpinistike 25 Maja. Pesë grupe alpinistësh u ngjitën gjatë dhjetë ditëve në mbi 25 nga majat më të larta të Alpeve tona në kuadër të 25 vjetorit të ditës së çlirimit (29 Nëntorit). Midis pjesëmarrësve në këtë ekspeditë ishin edhe dy ish nxënësit e mij nga gjimnazi, Piro Liko dhe Leonidha Druga. Dhe këta nuk ishin ish gjimnazistët e vetëm nga gjimnazi i Patosit që ishin inkuadruar me ekipin e alpinistëve në Klubin Sportiv Studenti.

Në verë-vjeshtën e vitit 1971 m'u plotësua dëshira që të kaloj me punë pranë familjes, në Tiranë (në shkollën 8-vjeçare Krrabë). Ndarja nga ekipi ishte një dhimbje e heshtur dhe e madhe. Isha i bindur se tashmë ishte krijuar një ekip të cilin e vlerësoja se ishte më i miri për kohën. Me këtë ekip mund të ndërmeroja çfarëdolloj veprimtarie që do të ndërtoja në mendjen time, që ishte për alpinizëm e për shoqëri mali, e që kudo gjetkë do më duheshin vite për ta krijuar. Koha tregoi se një ekip të tillë unë arrita ta ndërtoj tek Klubi Sportiv 17 Nëntori vetëm pas gati dhjetë vjetësh punë, por që sigurisht nën këndvështrimin teknik u arrit më i plotë dhe më cilësor. Dhe ajo për të cilën më vinte keq edhe më shumë në kohën kur u largova, ishte se nuk kisha patur kohë të mjaftueshme që të lija një pasardhës, sikundër do e dëshiroja, për ta vazhduar punën.



Në kuadër të përfundimit të elektrifikimit të vendit tonë maja e Vishensit (2.517 m) u pagëzua me emrin Maja e Dritës. Pjesëmarrësit: (L) Vullnet Zylyftari (Studenti), Vangjel Zeno (Apollonia), Vangjel Polo (Studenti, ish nxënës i gjimnazit Patos), Vullnet Kalemi (Apollonia); (P) Petraq Rista (Apollonia), Piro Liko (Studenti, ish nxënës i gjimnazit Patos)

Ekipi i alpinistëve Apollonia u rigjallërua vetëm atëherë kur u kthyen ish-nxënësit e mi gjimnazistë të këtij qyteti nga studimet universitare.

Por e mira nuk vonoi: pas një viti, në shtator të vitit 1972, mbasi kreu studimet universitare, u emërua me punë në Patos ish gjimnazisti i qytetit Piro Liko. Ai e ndoqi alpinizmin gjatë kohës që ishte student dhe kështu ai erdhi në ekip si ish alpinist i KS Studenti dhe u caktua trajner i ekipit Apollonia.

Absurdi i kohës enveriste bëri që një ditë të vitit 1975 të dalë një udhëzim që klubet sportive të përqëndroheshin në sa më pak sporte! Klubi Sportiv Apollonia një ndër “thjeshtimet” që bëri ishte shpërndarja e ekipit të alpinistëve me arsyetimin që



Një kujtim nga koha e
gjimnazit me ish nxënësin
tim Piro Liko

“Rrethi i Fierit nuk ka male”! Në ato kohë që të thoje se “edhe Parisi, Londra, Moska, etj nuk kanë male, por megjithatë kanë alpinistë me famë botërore “ ishte me pasoja për individin dhe më gjërë. Megjithatë djemtë ishin ngulmues dhe Klubi Sportiv Apollonia e riorganizoi ekipin e alpinistëve. Trajner u caktua Eqerem Shehu, edhe ky një ish gjimnazist i Patosit dhe ish alpinist i Klubit Sportiv Studenti.



Një kujtim, nga një seminar me trajnerë në malin e Dajtit, me Eqerem Shehu, ish nxënës i gjimnazit të Patosit që u bë trajner i ekipit të alpinistëve Apollonia, në kohën kur ekipi e rifitoi të drejtën për të përfaqësuar Rrethin e Fierit.

Klubi Sportiv i Tiranës

R ifillimi i jetës sime në Tiranë tashmë lidhej edhe me dëshirën për të trokitur në një derë të klubeve sportive të qytetit në mënyrë që të vazhdoja të ushtroja sportin e alpinizmit. Që nga koha kur fillova punën, pra pasi mbarova studimet universitare, rreth gjashtë vjet unë në opinionin e alpinistëve quhesha si sportist tek “rrethet” dhe jo tek “tironsit”, të cilët përfaqësonin disa ekipe alpinistësh. Gjatë kësaj kohe kisha patur rastin që nga “jashtë” të ndiqja klubet e kryeqytetit dhe të vlerësoja si nivelin e tyre alpinistik ashtu dhe të dëgjoja opinionin e “rretheve” (nuk druheshin nga unë për tu shprehur) për “tironsit.” Dhe ky opinion ishte negativ. Në vitin 1971 në qytetin e Tiranës nuk ishin të rrjeshtuar në ekip alpinistë shumë të mirë si Ali Ago, Ismail Hoxha, Niko Stamo e ndonjë tjetër, që ishin cilësor dhe të vlerësuar nga unë! Edhe ata që ne, ish anëtarë të ekipit studenti, i quanim “çunat e Luigjit”, dhe që unë i vlerësoja nuk ishin bashkë. Kisha ndjesinë se nga alpinistët e qytetit ishte hequr “ajka”.

Tek isha në ujra për të vendosur se ku duhej të trokisja, më kërkon dhe më takon Esad Pazari, mësues fizikulture, tiranas me

rrënjë (tiron) dhe n'atë kohë me detyrë inspektor me gjysëm norme në Klubin Sportiv 17 Nëntori. Ai aty kishte detyrë kryesore të mbulonte alpinizmin. Më bëri të ditur se kishte marrë premtim nga eprorët e tij se po të gjente një trajner bindës për ta, ata do e lironin nga ajo gjysmë norme me Klubin e Tiranës dhe ai e kishte të rregulluar punën që të kalonte mësues fizikulture me normë të plotë në një shkollë, gjë që e dëshironte. Andaj dhe më kërkoi që “t’ja bëja këtë nder”.


Nguroja. Ai insistoi dhe njëherësh më shpjegoi se kohët e fundit e kishte riorganizuar për mirë ekipin dhe kishte emëruar Kiçkën (Kristaq Korçarin) trajner. Madje kishte biseduar si me drejtuesit e Klubit, si me ekipin dhe me Kiçkën dhe unë isha i mirëpritur që të merrja detyrën e trajnerit. Tek e fundit pranova.

Ishte vjeshtë e vitit 1971 kur vajta në Klubin Sportiv 17 Nëntori dhe mora detyrën e trajnerit të ekipit të alpinizmit, detyrë të cilën e mbajta deri në Qershor 1992, kohë kur emigrova në Sh.B.A.

Periudha 1971-1977 nuk kaloi e këndëshme me ekipin: elementët që gjeta, për moshën që kishin, nuk mundej të përparonin ndjeshëm në cilësi dhe mentalitetet e anëtarëve të ekipit për stërvitjen ishin larg me të miat. Po ashtu, duke u emëruar me punë në shkollën e Krrabës, (më merrte shumë orë dita e punës për arsye të nivelit të mjeruar të transportit n'atë kohë) ishte e vështirë të gjeja elementë të cilët do të shkëlqenin mbi ata që gjeta në ekip. Ata që ecën më shumë nga ekipi ishin Shefki Juma (sikur ky të mos ishte dërguar për të punuar në Hidrocentralin e Fierzës do të kishte arritur edhe më shumë si alpinist) Dashamir Fejzo dhe Kristaq Korçari. Por arritjen më të madhe e pati më i riu që gjeta në ekip, Romeo Manxhari, i cili arriti të jetë i pari alpinist në Shqipëri që ta **meritojë**

titullin Mjeshtër Sporti bazuar në Klasifikimin Unik Sportiv për alpinizmin, për këtë titull, por që kurrë nuk ju dha ky titull (!).

Periodha 1977-1981 është periudha kur Klubi ynë krijoi sistemin zinxhir të ekipeve. Fillimisht shpenzova kohë të pallogaritshme për të mbledhur djem nga shkollat e mesme e profesionale për të krijuar ekipin e të rinjve. Shkoja shkollë më shkollë; hyja nëpër klasa e bisedoja për 5-10 minuta me nxënësit në mbarim të orës mësimore dhe në mbyllje të ditës mësimore. Me raste mbaja leksion të ilustruar me fotografi me temën “Ç’është Alpinizmi? (kjo bëri që t’i futem edhe një punimi që doli në vitin 1980 me titullin “Alpinizmi”).



Botim i vitit 1980



Andon Tapia me një pjesë të ekipit të të rinjve gjatë një veprimtarie dimërore në Bogë

Kur u mbledhën djemtë për ekipin e të rinjve filluam stërvitjen (në orë të ndryshme nga ai me ekipin e të rriturve) dhe kur e pashë që ky ekip ishte “i lidhur” ftova për trajner të ekipit të të rinjve, sigurisht me leje dhe dakortësi nga drejtuesi i KS 17 Nëntori, Andon Tapinë që pranoi pa hezitim. Pas kësaj ndërtuam ekipin e pionierëve me trajner Shefki Juma. Këta dy zotërinj bënë me këto ekipe një punë shumë të mirë duke punuar me përkushtim dhe me pasion.

Krijimi i ekipeve të alpinistëve pionerë nëpër Shtëpitë e Pionierëve në lagjet e Tiranës dhe në Pallatin e Pionierëve (n’atë kohë këtë ekip e drejtonte Mario Trinkera, i cili erdhi në ekipin tonë pasi u largua nga ekipi Dajti) dhe lidhja me këto ekipe për të vjelur elementin për në ekipin e të rinjve tanë u bë mënyrë pune. Ndër këto ekipe, ai i Lagjes Kombinati i Tekstileve bëri emër si rezultat i faktit se ekipin atje e drejtoi Dashamir Fejzo dhe Drejtor i Shtëpisë së Pionierit atje ishte



Shefki Juma dhe ekipi i pionerëve në malin e Dajtit, tetor 1980

Flamur Bërdëllima, njeri me prirje për të bërë mirë e punuar mirë në këtë shoqëri.

Andon Tapia, Shefki Njuma, Mario Trinkera dhe Dashamir Fejzo me përvojën që kishin fituar ishin gjithnjë të parapëlqyer



Mario Trinkera dhe ekipi i Pallatit të Pionierëve

që të caktoheshin nga Federata e Alpinizmit drejtues togash apo edhe veprimtarish alpinistike kombëtare dhe prania e tyre në këto veprimtari mundësonte që anëtarët e ekipeve tona (edhe në veprimtaritë kombëtare) të drejtoheshin e të kishin mbi kokë këta zotërinj të cilët kishin “filozofinë tonë” të alpinizmit e cila ishte bërë “aroma e klubit alpin të Tironës.”

Krijimi i një sistemi zinxhir ekipesh brënda Klubit Sportiv 17 Nëntori si dhe lidhja me Shtëpitë e Pionierëve na mundësoi që në ekipin e të rriturve të vinte element i ri i zgjedhur të cilit i zhvillohej pasioni e dëshira për tu marrë me alpinizëm që në moshë të re. Kjo bëri që një ditë të ndieja se kisha një ekip shumë të mirë, madje në opinionin tim, ekipin më të mirë alpinistik duke filluar nga viti 1980. Me të mundej të ndërmerrja çdo lloj veprimtarie apo itinerari ngjitjeje në alpet tona. Dhe për të realizuar këto arrita të krijoj një logjistikë me bazë materiale e cila na mbështeste shumë mirë për veprimtaritë dhe ngjitjet që ndërmorëm.



Disa nga alpinistët më në zë të ekipit: Romeo Manxhari, Dashamir Fejzo, Niko Stamo, Ilir Tapia, Shefki Juma. Andon Tapia, Aleksandër Bojaxhi, Sokol Doko, Gjergj Bojaxhi, Xhemal Begeja

Marrëdhëniet me drejtuesit.

Tek Klubi Sportiv 17 Nëntori gjeta Kryetar Dhori Hanxharin. Nuk kaluan 6-7 javë nga dita që u vendosa trajner dhe në fillim të muajit nëntor shkuam në malin e Dajtit për një grumbullim para një veprimtarie, e cila do të organizohej në kuadrin e Kongresit të Partisë Punës së Shqipërisë të atij viti. Kur erdhi dita për tu nisur unë nuk e shoqërova ekipin për arsye se Drejtoria e Punëve të Brendëshme të Tiranës nuk më dha leje të kalimit në zonat kufitare. Arsyeja ishte biografia familjare: im atë ka qënë i arrestuar më 1947 dhe dënuar si Armik i Popullit. “Faji” i tij ishte se kishte kryer Shkollën Teknike të Tiranës, më pas kishte qënë dhe pjestar i trupës pedagogjike (mësim dhënës/instruktor). Fillimisht nuk ma thanë arsyen, por një javë pasi mbaroi Kongresi i Partisë më thirrën tek zyra e Kryetarit të Klubit dhe ai bashkë me sekretarin e partisë së klubit (mos gaboj ka qënë Nuri Bylyku) më treguan arsyen e moslejimit tim në veprimtari dhe shtuan që “ne e kemi shoshitur edhe me instancat e duhura këtë punë dhe pas kësaj një gjë e tillë nuk do të ndodhë më. Vazhdo punën e mos u shqetëso. Të na falësh (njerëzi jo e zakonshme për kohën!) që nuk i kemi bërë këto punë me kohë.”

Më pas në Klub u emërua kryetar Muharrem Sinoimeri, njeri pozitiv sikundër ka qënë gjithë jetën dhe i dhënë pas alpinizmit e veprimtarive në natyrë. Ai kishte qënë emëruar Sekretar i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar në qershor 1964 dhe njiheshim. Muharrem Sinoimeri e dinte si pakkush që alpinizmi donte bazë materiale që “të bëhej” dhe nuk u kursye që të na hapte rrugë në çdo gjë që arsyeja dhe normativat shtetërore për pajime për këtë sport e donte që t’i sigurohej ekipit.

Nëse Klubit Sportiv të Tiranës i ikte një kryetar dhe i vinte një tjetër, i vinte e i ikte një sekretar partie apo një punonjës dhe këta merrnin vlerësimet tona si trajnerë, punonjës a sportistë aty si “i mirë”, “hë”, “e mor!...”, etj., ylli me të njejtin shkëlqim i administratës së Klubit Sportiv të Tiranës për gjithë 21 vitet e mia që isha aty ishte dhe mbeti Efigjeni Kote (Xheku), shefja e llogarisë së Klubit. Ne na ndihmonte sa ja mundësonte “lapsi” për tu pajisur si duhet, por jo vetëm kaq.

Përvoja e fituar në Fier për të pajisur ekipin më kishte mësuar tu drejtohesha ndërmarrjeve artizanale të cilat mundësuan prodhime të pajisjeve prej leshi (atëherë Ndërmarrja Artistike Migjeni). E njejta gjë ndodhi me rancat (çantat e shpinës). Ky është një artikull i cili merr një rëndësi të veçantë për alpinistin të cilit i duhet të udhëtojë me orë të tëra duke patur pajisjet dhe ushqimet e futura në të. Një mbushje e saj me barazpeshim të qëndrueshëm dhe e pajisur me rripa që e shpërndajnë barrën sa më uniformisht në shpatulla dhe shpinë janë domosdoshmëri për një marshim normal. Tek Ndërmarrja e Prodhimit të Mjeteve Mësimore e Sportive gjeta një mjeshtër që drejtonte një repart në sektorin e prodhimeve sportive, të cilit çfarë i shihte syri ja bënte dora (emri i tij nuk më kujtohet). Me të arritëm të bëjmë një prodhim të parë rancash për ekipin në bazë të një modeli të ardhur nga jashtë. Prodhimin e eksperimentuam në veprimtarinë më të parë dimërore. Doli se rancat ishin shumë të mirë dhe kur arritëm të vemë në vijë një prodhim të madh për ekipet e sistemit zinxhir si edhe për klubet e tjera, mjeshttrin, për arsye të martesës që bëri (ai ishte meso burrë), e internuan në Rozaverë me gjithë të shoqen. Më vonë rancat u punuan në një rrobaqepsi të Tiranës, por nuk u bënë kurrë më si prodhimi që nxorri ai mjeshtër.



Një kujtim në Alpe me
Mario Trinkera

Për kostume dimërore përdorëm shajak të hollë, kurse për kostume verore prodhuam xhakovento me kapuç dhe pantallona tip golf (qillota) me dokun më cilësor të kohës, atë të Kombinatit të Tekstileve në Berat, të siguruar me ndihmën e Petraq Kules.

Për karabina dhe plenga ju drejtova Ndërmarrjes Metal Punuese (?) 17 Nëntori që në atë kohë ishte në të njejtën rrugë ku ishte edhe hyrja e kinemasë me të njejtin emër. Aty gjeta mjeshtra që morën përsipër prodhimin: zbërthyen dy karabina që u çova për model, panë pjesët përbërëse dhe ndërtuan pajisje për prodhimin në seri të tyre. Prodhimi i plengave (ngolat e shkëmbit) nuk ishte problem për ta. Për to, dikur kish pas ndimuar në rang kombëtar Ing. Mihal Bozdo, sikundër edhe për kazmat alpine edhe Vilson Kosturi.

Ndërmarrjet ku arritëm të prodhojmë pajisjet e veshjet tona shpejt u bënë furnizuese të porosive edhe për klubet e tjera, përjashtuar disa klube e disa artikuj që klubet e rretheve i mundësuan t'i prodhojnë në qytetet e tyre.

Prodhimi dhe sigurimi i bazës materiale u arrit në rradhë të parë me ndihmën financiare të kubit si dhe kohës (ditë e orë “të pafundme” interesimi e ndjekje të proceseve që kërkonte prodhimi i tyre) që shpenzova për të arritur që të përfshij në prodhimin e tyre ndërmarrjet artizanale të kohës.

Në ekipin tonë ndihmë të veçantë për pajime dha edhe Dashmir Fejzo i cili me mundësitë e tij aty ku punonte (Reparti Mekanik në Kombinatin e Tekstileve) prodhoi plenga, kunja për tendosje tendash, majtha, etj., që na vlenin shumë. Ai ndihmoi edhe për prodhimin e pjesëve të druja për disa prej pajimeve tona, me dru frashëri e thane që ne i siguronim përreth fshatit Shërmi mbi Linzë kur ktheheshim nga stërvitjet e kryera në malin e Dajtit.

Plotmëria me bazë materiale më mundësoi, me leje nga drejtuesit e Klubit, që të ndihmoja klubet që kishin trajnerë pasionantë e me vlera njerëzore si Gëzim Laçin e Pukës dhe Nuredin Secin e Valbonës me ekipet e tyre, si dhe, më vonë ekipin Dajti.

Stërvitja

Tek Klubi Sportiv 17 Nëntori ekipi i alpinistëve, që para vjeshtës së vitit 1971, kishte një dhomë të vogël, një modifikim si shumë të tjera i pjesës me strehë që i vinte përqark Kishës Orthodoxke të Tiranës në rrugën e Kavajës. Kjo Kishë, pasi u ndalua ushtrimi i fesë më 1967 në Shqipëri, ju dha “për shfrytëzin”

klubit tonë sportiv. Dhomëza ishte në anën e kundërt me kullën e këmbanës së kishës, e cila kullë shfrytëzohej me kohë nga ekipi kryesisht për zbritje me litar. Në dhomëz mblidheshim për veshje e zhveshje në ditët e stërvitjes, për ndonjë mbledhje të vogël (leksione teorike) dhe për të mbajtur pak bazë materiale. Fillimisht dhoma ishte pajisur me ulëse që duket ishin përdorur në kishë. Kaluan muaj dhe klubi na dhuroi një raft të madh, të cilin e kishte përdorur kabineti i mjeksisë së klubit, me dy dyzina kubikësh ku secili alpinist kishte mundësi të mbante veshje dhe materiale teknike për stërvitje.

Gjatë kohës që kishim dhomën e stërvitjes tek ish Kisha, fillimisht ekipin e gjeta që bënte stëvitje në terrenet sportive të Klubit që ishin aty, në rrugën e Kavajës, e që në Tiranë njihej si Parku i Xha Tonit (një keqinterpretim “plot letërsi” i emrit të Xhetanit). Xhetani ishte një i moshuar tejet i nderuar nga ne trajnerët dhe sportistët për punën dhe kujdesin që tregonte për mirëmbajtjen e terreneve sportive ku më të privilegjuarit ishin ekipet e lojrave me dorë. Më vonë e spostova vendin e stërvitjes tek Fusha e Aviacionit. Atje shkonim pasi zhvisheshim në dhomë: kalonim nga Rruga e Kavajës në Rrugën Naim Frashëri e prej aty nëpër hapsirat e atyre pak banesave që ekzistonin atëherë kalonim drejt e tek Fusha e Aviacionit, ku kishim mundësi që të ushtroheshim më shumë në vrapime dhe ushtrime gjithëfarsoj në natyrë të hapur dhe në fund me lojë futbollit.

Dikur, me synim ngritjen e cilësisë së stërvitjes, filluam të stërvitemi tek Parku (Liqeni) i Qytetit të Tiranës. Kërkesa ime gjeti aprovim e mbështetje nga trajnerët e atletikës të cilët kishin palestrën e tyre poshtë shkallëve të stadiumit kombëtar fill në vazhdimin jugor të tribunës qëndrore. Na u mundësua vend për zhveshje dhe mundësi për të përdorur veglat e tyre ushtrimore

kur ato ishin të lira. Trajnerët e ekipeve të atletikës të cilët kishin punuar atje për të krijuar mjedise stërvitore që i afroheshim nevojave të kohës dhe që më ranë në sy për përkushtimin e tyre nuk ishin pak. Kujtoj ndërmjet tyre trajnerët Ramazan Driza, Azis Ruli, Suat Jegeni, Petrit Qendro, etj. Në atë fillim nuk e dinim se së shpejti do të bëheshim edhe ne me dhomën tonë aty pranë.

Erdhi një ditë që me ndihmën e ndërhyrjes zyrtare të Klubit dhe me dashamirësinë e Drejtorit të Doganave për Tiranën Bajram Muça, të cilin e njihja familjarisht, ekipit ju dha një dhomë, që e përdorte si magazinë Drejtoria e Doganave – Tiranë, nën shkallët e Stadiumit Kombëtar Qemal Stafa, bash ngjitur me derën e hyrjes për në tribunën ku ndodhej ora e stadiumit. Pra ishim në një farë mënyre një vazhdim “i katit të sipërm” i palestrës së atletikës.

Në dhomë krijuam mjedise jo vetëm për zhveshje e veshje por edhe për të mbajtur ca bazë materiale. Arritëm të krijojmë edhe një klasë të mirëfilltë mësimore me tavolina, stola e tabelë (më ndihmoi administrara e shkollave, konkretisht Nexhmije Stërmasi dhe Polikseni ?) e me hoje (dollape) për mbajtjen e materialeve. Shefki Juma ndihmoi që të kishim “garderobë” të bollshme duke punuar varëse metalike, derë metalike në formë rrjete si dhe pajisje të tjera që lidheshin me hekurin dhe saldimin. Disa nga anëtarët e ekipit ndihmuan sadopak dhe krijuam vërtet një klasë tip “shkollë e vogël” që shërbente plotësisht edhe për leksione, diskutime dhe përgatitje të plotë intelektuale. E theksoj këtë lloj përgatitje ngase nuk më pëlqente që ata të cilët vinin në mal të mos kishin sadopak njohuri të nevojshme teorike për natyrën, zonën e veprimtarisë, teknikën, taktikën, pajimet, etikën sportive, etj. që i kërkonte sporti ynë

dhe kultura e marrdhënieve me natyrën. Dhoma jonë, desh fati, erdhi e u plotësua në kohën kur ne kishim filluar të punonim me sistem ekipesh zinxhir: të rritur, të rinj dhe pionierë.

Në kohën kur u bëmë me dhomë në stadium, ne tashmë e kishim të “studiuar” mjedisin përqark dhe shfrytëzonim “palestrën natyrë” për çdo gjë të mundshme në drejtim të të veçantave të sportit tonë për stërvitje. Kështu, një pjerrësi të terrenit në park, që ishte e theksuar, e përdornim për manovrimet me kazëm, për të fituar shprehitë e mbajtjes së saj sipas pjerrësisë së terrenit; pjesa e betonuar e digës së liqenit përdorej për ecje të lirë e të tërthortë që të ushtronim kavilet si në rastet e ecjes me kthetra në terren të ngjirë. Fillimisht muret e stadiumit, e pasi këto u suvatuan, muret e gurta të korpusit qendror të Universitetit (sot Universiteti Politeknik) u shfrytëzuan për kacavarje. Një kërcu i madh që u gjet në park dhe që si ekip e sollëm pranë dhomës sonë u ngrit rreth 2 metra midis dy pemëve. Çuditërisht ai kërcu kishte një formë e një madhësi të tillë që ngjitja mbi të ishte një ushtrim i shkëlqyer që imitonte kalimin e një të dale (sqetë) shkëmbore. Në pemët e mëdha (me trung të madh) u ngulën plenga dhe në to u imitua kacavarja me ndihmën e capanëve e shkallëve si dhe manovrimi i litarëve për teknikat e ngjitjes me përdorimin e dy litarëve. Tribuna përballë qendrores së stadiumit u shfrytëzua shpesh për zbritjet me litar. Këto përsa i takon mundësive që ekzistonin aty për ushtrimet në teknikë.

Përsa i takon përgatitjes së përgjithshme fizike: duke patur mundësinë që hera herës të ushtroheshim edhe në palestrën e atletikës (të mbyllur e poshtë shkallëve të stadiumit), Parku i Tiranës që atëherë ishte gati një pyll “i pyllëzuar”, ishte një parajsë e kohës për përgatitjen e përgjithshme fizike të ekipit. Sulë Huqi, punonjësi i klubit për mirëmbajtjen e mjediseve aty,

i cili kulloste edhe lopën e tij në park, kujdesej për ujë të ngrohtë për dushin pas stërvitjes, por që kur mungonte lënda djegëse ne e bënim këtë dush, dimër e verë (jo rrallë), me ujë Selite që aty rridhte për gjatë gjithë ditës.

Mali i Dajtit ka qënë gjithnjë simbol natyror i qytetit të Tiranës. Ky mur i blertë është jo vetëm sfond natyror i qytetit tonë por për alpinistët e tij (jo vetëm të ekipit tonë) edhe një poligon stërvitje. Fjala stërvitje në Dajt me kohë mori kuptime të ndryshme. Pa përmendur fillimet turistike të aristokracisë tiranase dhe durrsake (për t'ju larguar mushkonjave) me vajtjet familjare në Dajt në baraket e ndërtuara aty, si dhe veprimtari të tjera sportive që kryheshin në të e deri në majën e tij, duke filluar nga viti 1958 gjatë pushimeve dimërore universitare ky mal u kthye në shkollë të mësimit të njohurive alpinistike (shkolla kishte emërtimin “Zbor Alpinistik”). Madje të gjithë studentët universitarë e kishin ngjitjen nga Kinostudio në majën e Dajtit si një nga normat (notë) e kalimit të lëndës së fizikulturës. Kjo vazhdoi deri diku rreth mesit të viteve 60-të dhe më pas ata që e morën detyrën e drejtimit të Katedrës së Fizikulturës në Universitetin e Tiranës nuk patën as vullnet e as aftësi për ta vazhduar traditën e filluar. Porse tashmë rinia tiranase, dhe më gjërë, e kishte mësuar rrugën për në malin e Dajtit. Madje vajtja/ngjitja në Dajt u bë veprimtaria më “lluksoze” e rinisë së asaj kohe. Paraprakisht kolektivat e ndërmarrjeve apo shkollave suguronin fjetjen sipas një grafiku të ndërtuar nga një zyrë ndërlidhëse në Tiranë. Punonjësit e ndërmarrjeve e kalonin natën aty të shtunën, kurse shkollat në ditë jave. Vinin aty nga Tirana dhe nga gjithë vendi. Kalimi i natës aty, me muzikë e vallëzim, ndoshta duhet konsideruar si DISKO e parë në vendin tonë, dhe ishte vërtet shumë argëtues.

Veprimtaria e spikatur e Luigj Shalës me fëmijë e të rinj në Pallatin e Pionerëve Tiranë (pas vitit 1966 grupet e fëmijëve u drejtuan nga Ali Ago, Myftar Marku, Kristaq Korçari, etj.) i mësoi edhe atyre që në vitet 50-të rrugët për ta ngjitur malin e Dajtit. Kështu, pas krijimit të Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit Shqiptar më Qershor 1964, ekipet turistike dhe alpinistike që u krijuan në Tiranë “e futën” malin e Dajtit në programin e tyre stërvitor.

Edhe ekipi që tashmë drejtoja e kishte përdorur malin e Dajtit si vend stërvitje: ishte mjaft i vlefshëm për ngjitje e zbritje të terrenit malor e me shumë mundësi stërvitje për teknikat e kalimit të relievit në sezonin dimëror. Kjo veçanërisht në zonën që ne e quajmë “prapa” Dajtit, por pak i njohur për mundësi kacavarje në shkëmb (zbritjet me litar ishin të zakonshme në disa vende të malit).



Luigj Shala me anëtarë të grupit turistik të fëmijëve të Pallatit të Pionerëve

Teksa drejtoja ekipin Apolonia kisha ardhur për stërvitje (në ditët e grumbullimit veror) në Dajt për kacavarje shkëmbore. Duke hetuar me sytë e një kacavarësi vendet më të mira për stërvitje e ngjitje ato i gjeta sipër, atje tek shkon rruga automobilistike (nën të) teksa i afrohesh Fushës në malin e Dajtit. Por për të vajtur deri atje, çdo të dielë, për ne do ishte problem transporti (që ishte i pamundur që të sigurohej) kurse marshimi në këmbë deri aty të merrte shumë kohë. Edhe faqja jugore e fortesës së Petrelës nuk na kënaqi sepse transporti për të vajtur aty ishte i vështirë.

U gjet një zgjidhje: një shkëmb në pyll, mbi Linxë, në të djathtë të përroit që zbret nga Shërmia. Filluam stërvitjet aty. Ishte shkëmb shumë i mirë, por ky shkëmb u bë shpejt “i vogël” për numrin e pjesëmarrësve në stërvitje.



Faqe e fortesës së Petrelës



Shkëmbi pranë
Linxës në shtegun
drejt Shëmrisë

Nevoja për shkëmb të mjaftueshëm për stërvitje bëri që me anëtarë të ekipit, hera-herës, të shkoja shkëmb më shkëmb nga Tujani në drejtim të Surrelit. Pra, në të gjithë faqen e malit të Dajtit që shikon Tiranën. Në këtë kohë më kujtohet se më të shumtat e kërkimeve i kam bërë me Ylber Jumën. Dhe një ditë prej ditësh nga unë dhe Ylberi u gjet ai fragment shkëmbor që nga ne u quajt Poligoni i Dajtit: rreth pesë minuta ngjitje nga ajo rrugë e drejtë, e që në zhargonin tonë quhej “fusha,” në shtegun e ngjitjes nga gurorja për në malin e Dajtit. Punuam aty dy vende. Kur them punuam kam parasysh faktin se me sopata e sharrë hapëm shtigje në shqopat, dëllenjat, maretë e shkozat rrotull pjesëve shkëmbore (ishte e habitshme të shikoje tarraca buqësore, tashmë të pyllëzuara, që tregonin tokat e dikurshme

të punuara mbi fshat). Një 80 vjeçar që banonte me familjen në të vetmen shtëpi aty pranë “fushës” dhe që e takonim shpesh tek kullostë bagëtitë e tij përgjatë shtegut për tu ngjitur në majë, më pati thënë se “dikur, prej këtu e deri në Tujan macja kalonte pullaz më pullaz”. Po ashtu më pati lënë mbresë fakti se mbi fshat (Shëmri), pranë brezit shkëmbor kishte mbetje tjegullash e qeramikë që të bënin të mendoje se fshati ka qenë edhe më i madh shekuj më parë.

Pasi e “fiksua” poligonin shkëmbor për kacavarje bëmë shënjimin me ngjyrë të kuqe të itenerarëve ku do fillonin kacavarjet. Filluan dhe ngjitjet për përcaktimin e vështirësisë së itenerarëve. U piketuan për kacavarje shumëllojshmëri të relievit shkëmbor. Itenerarët u shënuan me bojë: I1, I2 etj., dhe për secilin prej tyre llogarita ngarkesën fizike në **pika kapje**. Më pas



Ushtrim në përdorimin e litarit me një treshe kacavarësish në poligonin shkëmbor



Kacavarje me sigurim nga lart në poligonin shkëmbor

modelova *fletën e stërvitjes*, një “formular” ky për çdo dy alpinistë që përcaktonte programin stërvitor të ditës në këtë poligon. Për shtypjen e formularëve si dhe materialeve të tjera të shtypura për ekipin, më ka pas ndihmuar një punëtor shtypshkronje tek Instituti i Meteorologjisë në rrugën e Durrësit, Fatmir Asllani, me të cilin kryenim bashkë stërvitjen ushtarake vjetore.

Poligoni	Intenero	Herë	Sigurimi	Grafësia	Poligoni	Zonitje	Herë	Mënyra	Gatësia	Data
A	1	3		11	A	3	9	sp. ud.	63	25.3.84
	2	3		18						
	3	3		21						
	4	3		21						
	5	3		15						
	I ₁	2	last	30						
	I ₂	2	last	30						
	I ₃	2	last	30						

N^o 12 Sakul Doko

Poligoni	Intenero	Herë	Sigurimi	Grafësia	Poligoni	Zonitje	Herë	Mënyra	Gatësia	Data
A	1	3		31	A	3	9	sp. ud.	63	25.3.84
	2	3		18						
	3	3		21						
	4	3		21						
	5	3		15						
	I ₁	2	last	30						
	I ₂	2	last	30						
	I ₃	2	last	30						
B	I ₁	3	last	42 m						29.4.84
	I ₂	3	last	45 m						
	I ₃	3	last	59 m						
A	S ₀	2	last	30 m	A	3	4	sp. ud.	28 m	15.5.84
	S ₁	2	last	30 m						
	S ₂	4		24 m						
	S ₃	4		28 m						
C	I ₁	2	last	64 m						17.5.84
	I ₂	1	"	14						
	I ₃	1	"	15						
	I ₄	1	"	15						

Fletushka e stërvitjes dhe ajo përmbledhëse për sezonin

Çdo dyshe e ekipit e pranishme në stërvitje merrte një “fletushkë stërvitje” (ku rreshtoheshin disa itenerarë) e cila tregonte itenerarët që do të ngjiste alpinisti si dhe herët e kryerjes për sejcilin itenerar. Në veprimtaritë kombëtare kisha qëmtuar numrin e kapjeve në disa nga itenerarët e shkallës së katërt të vështirësisë. Kisha arritur në përfundimin se një litar ngjitje me shkallë të katër të vështirësisë kërkonte mesatarisht 120 kapje. Kacavarja me gjatësi tre litarë në veprimtaritë kombëtare ishte një mesatare e kohës dhe kështu një stërvitje me rreth 350

kapje, sipas meje, ishte mëse e mjaftueshme si ngarkesë fizike për duart apo kapjet për ato vite, në kohën kur stërvitja arrinte në periudhën 2-3 javë para fillimit të veprimtarive verore.

Në sezonin dimëror stërvitja kryhej me ngjitje në majë të malit të Dajtit në itenerarë të ndryshëm, apo edhe me kalimin e kreshtës së malit apo një pjese të saj, dhe me raste, aty kalonim rreth pesë ditë stërvitore grumbullim, nga shtatë që na jepeshin. Dy ditë i linim përgatitjes për nisje (organizimit; d.m.th. kujdesje për sigurimin dhe sistemin e ushqimeve dhe pajimeve). Më kujtohet që në mal grumbullimi i ekipit para fillimit të veprimtarisë për herë të parë u krye në verën e vitit 1972 në Breg – Lumi, Dukagjin. Një grumbullim dimëror (në muajin shkurt) nga fundi i viteve tetëdhjetë e kemi pas organizuar tek Gropa e Portës nën Shtegun e Dhenve. Sa herë që na jepej mundësia për grumbullime para nisjes së veprimtarive, ato veroret i bënim në zona malore, por jo në malin e Dajtit.

Komisioni teknik

Federata e Alpinizmit dhe Turizmit Shqiptar u krijua në Qershor të vitit 1964 me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të një vendimi (ose propozimi) të Komitetit Qëndror të PPSH të vitit 1963. Krijimi i Federatës shënoi edhe kohën e formatimit e krijimit të ekipeve alpinistike në bazë klubesh dhe rrethesh, përjashtuar Klubin Sportiv Studenti i cili tashmë ishte qendra e alpinizmit shqiptar. Kryetari i parë i Federatës ka qenë Kiço Ngjela, i cili ndihmoi mjaft në sigurimin e bazës së parë materiale për përhapjen e veprimtarive të kësaj Federate, i cili shpejt u pasua në këtë funksion nga Kristo Papajani, njeri shumë aktiv. Sekretari i parë i Federatës u emërua Muharrem

Sinoimeri i cili ndenji në këtë detyrë deri në vitin 1969 ose 1970. Sekretarët që e pasuan atë ishin Andon Tapia, Seit Veseli, Eqerem Shaba dhe Vladimir Gjoni (1992). Federatës një ditë prej ditësh ju shtua sporti i çiklizmit (u **fut** biçikleta në federatë) dhe diku nga vitet 1980-të donin që t'i shtonin edhe hipizmin ("kalin nuk e zuri dera e zyrës dhe vendimmarrësit ndërruan mëndjel"). Federata kishte Kryesinë e saj që zgjidhej nga mbledhjet që bëheshin në instanca të caktuara të lëvizjes sportive. Në mbledhje Kryesia kam pas qenë ftuar një ose dy herë, si rregull për të dhënë mendim dhe kam qëndruar në një pjesë të mbledhjes. Federata kishte Komisionin Teknik të saj, të cilin besoj se e zgjidhte Kryesia e Federatës. Ky komision merrej me anën teknike të sportit dhe ishte formalisht këshillues për Kryesinë. Komisioni ishte vendimmarrës për gjëra teknike.

Besoj se ishte fundi i vitit 1967 kur u thirra për të marrë pjesë në një mbledhje në Federatë. Kur filloi mbledhja mësova se ishte mbledhje e Komisionit Teknik të Alpinizmit dhe se unë isha anëtar i tij. Nuk më kujtohen të gjithë pjesëmarrësit e asaj dite por mbaj mend fare mirë se ishin të pranishëm Muharrem Sinoimeri, Agim Kajanaku dhe Myftar Marku. Pika e parë e mbledhjes lidhej me propozimet për dhënien e titullit Mjeshtër Sporti. Unë isha i pari në listë (nuk e prisja këtë gjë dhe as më kish thënë gjë ndokush deri atë çast) dhe emri im kaloi me aprovim të plotë. Agim Kajanaku dhe Myftar Marku u diskutuan për të njëjtin titull nga të pranishmit por u la që puna e tyre të shihej në mbledhjen tjetër. Nga diskutimet mbaj mend se u la që do kishte gjasë që Agim Kajanakut t'i jepej titulli Mjeshtër Sporti në alpinizëm, por për Myftar Markun më e pranueshme do të ishte dhënia e titullit Mjeshtër i Turizmit Malor, të cilin titull Myftari e refuzonte. Kur çoja në mendje se si erdhi kjo

punë që unë kalova në propozimin që të më jepej titulli, thoja me vete se si duket ka ardhur koha të jepen tituj, ose ka njërëz që kërkojnë tituj, por kanë edhe moral, aq moral sa ta ndjejnë se n'atë kohë pa ma dhënë mua titullin (po them **dhënë** e jo merituar) do ishte habi në opinionin e alpinistëve që t'i jepej ky titull dikujt tjetër nga ajo listë. Pra, them se mua po më jepej titulli që të hapej rruga për të tjerë. Duket se n'atë kohë kishte ende ca moral sportiv ... dhe jo si gjatë viteve 80-të.

Titulli nuk mu dha në vitin 1968: mësova se ishte marrë vendim nga lart që titujt sportiv si dhe dekorime të tjera në sport të shtyreshin dhe të jepeshin gjatë vitit 1969, vit kur do të festohej me madhësi 25 vjetori i çlirimit të vendit. Dhe kështu ndodhi.

Që nga ajo kohë kam qënë vazhdimisht anëtar i Komisionit Teknik të Alpinizmit. Kam qënë i rregullt në mbledhjet e këtij Komisioni pasi u vendosa me punë në Tiranë në vjeshtë të vitit 1971. Përrjashtimi im nga ky komision ndodhi (pak a shumë) në periudhën vjeshtë 1975 – vjeshtë 1977, kohë kur mbi mua u ushtrua lufta e klasave. Alpinistët HM e MV spikatën në krye të kësaj lufte. Madje ky i fundit erdhi deri në Krrabë për të tundur flamurin e luftës së klasave e për t'i treguar Krrabës se unë isha djali i një armiku të popullit e nuk më takonte që të drejtoja shkollën aty (ishte koha që nga n/drejtor shkollë u emërova drejtor i shkollës). Nuk e di se sa u përfshinë në këtë kohë në këtë luftë klasash O dhe DH, por këta të dy mësova se u shquan më pas, madje thuajse deri në prag të rënies së enverizmit, me telefonata (anonime) dhe letra drejtuar Komitetit të Partisë. Kur vala e luftës së klasave ndaj meje **ra** rifillova të marr pjesë në veprimtari. Kujtoj se në dimrin e vitit 1977 Muharrem Sinoimeri më këshilloi që ende të mos shkoja në veprimtari dhe më sygjeroi

që të rifilloja pjesëmarrjen, duke ju bashkuar ekipit që gjithënjë e stërvisja, në verën e po atij viti. Në vjeshtën e vitit 1977 Sekretari i Federatës, me dëshirën dhe ndërhyrjen e Minella Kapos, më ofroi pjesëmarrjen përsëri në Komisionin Teknik.

Pra, një ditë nga fundi vjeshtës së vitit 1977 Sekretari i Federatës për kohën, Eqerem Shaba, i cili vinte nga klasa puntore (sikundër doli termi n'atë kohë), vendosi të më takonte. Flamurtarët e luftës së klasave më kishin nxiërë para tij, por erdhi një ditë që Eqeremi i parapëlqente konsultimet për alpinizmin si dhe shërbimet për të inspektuar ekipet e alpinizmit me mua, ose me mua dhe Kozma Grillon, dhe hera-herës intimitete "politike" i këmbente herë me mua e herë me Kozmain. U bëmë miq.

Mendoj se ja vlen të lë një dy kujtime (për brezin pas enverist) për ato muajt e **kulmit** të valës së luftës klasore që ra mbi mua dhe që e kishim në ato kohë të gjithë, kush më shumë e kush më pak, si pjesë të jetës.

Në Krrabë më dërgoi Komiteti Ekzekutiv në mes të shtatorit 1971 me emrim nën drejtor shkolle dhe pas katër vjetësh, një ditë tetori, erdhën dy shkresa që tregonin se drejtori ekzistues shkarkohej (kur ishim unë dhe ai – ai ishte me banim në Krrabë - në drejtimin e shkollës patëm një mbarvajtje pune dhe shoqëri kolektivi nga e cila përfitoi shkolla dhe trupa pedagogjike) dhe unë emërohesha drejtor. Emërimi më erdhi si habi! Porse diku nga muaji maj 1975 u hoqa nga kjo detyrë dhe komunikimi mu bë në një mbledhje në të cilën erdhi vetë deputeti i zonës, Sabri Sula, minator në Krrabë. Ishte burrë tradite. Ai erdhi në kolektiv ngase askush nga anëtarët e organizatës së partisë apo kolektivit që kishim nuk kish as zemër e as kurajo të bënte njoftimin (ma tha këtë deputeti). Motivi i shkarkimit: nuk jam treguar i sinqertë në plotësimin e dokumentave biografike.(!)



Me kolegë mësues në shkollën e Krrabës

Nuk kisha trokitur ndonjëherë nëpër zyra por këtë rradhë vajta dhe takova shefen (besoj) e kuadrit të Komitetit Ekzekutiv të qytetit, shoqen Vangjeli, e cila ishte marrë me çështjen time. Doli në korridor (si dukej nuk lejohej që të futeshe në zyrën e saj) dhe i kërkoja të më tregonte dosjen time e të shikonim bashkë se “ku ishte jo sinqeriteti”, por ajo më tha se, “dosja nuk tregohet!” Shumë e habitshme për mua, por ajo ishte e prerë për të mos më treguar as edhe **fjalinë apo paragrafin** tim të mos sinqeritetit. Pas kësaj vajta në Degën Ushtarake të qytetit: aty në gusht të vitit 1965 më kishin kërkuar, dhe e kisha dorëzuar, një biografi të hollësishme që sikundër më thanë e donin që nga gjyshërit e mi. Porse në Degën Ushtarake më thanë se nuk mbajnë biografi, madje dhe u habitën që mua dikur më kishin kërkuar biografi. Megjithëse u përshkrova personin me të cilin

kisha komunikuar (emrin nuk ja mbaja mend), por ata më thanë prerazi të largohesha sepse ata nuk kanë biografi.

Më pas i bëra një letër Kryeministrit duke i shpjeguar se çfarë më kishte ndodhur dhe i kërkova që të më gjendej e drejta me dokumentat. Ju drejtova atij ngase ai e njihte familjen time. Nuk mora përgjigje prej tij por, me shumë vonesë, mora përgjigje nga një sekretar i tij me mbiemrin (më ka ngelur në mendje) Kasapi (çfarë mbiemri për tu kthyer përgjigje njerëzve që kanë shqetësime!). Shkresa më bënte me dije se duhej t'i drejtohesha Komitetit Ekzekutiv të qytetit (gjë që unë e kisha bërë).

Meqë fillimisht nuk po më vinte përgjigje nga Kryeministri, vajta në Patos. Atje gjatë vitit 1967 na organizonin mbledhje në të cilat ne mësuesit, me rradhë, tregonim biografitë para kolektivit, biografi të cilat na i kërkoi me shkrim organizata e partisë së shkollës “me udhëzim nga lart.” Shpresoja ta gjeja aty zgjidhjen. U takova me Thoma Kolën, ish koleg e shok dhome në fjetoren ku banonim. I shpjegova problemin dhe i kërkova të më ndihmojë të gjenim PB, ish sekretarin e partisë të mësuesve n'atë qytet, i cili në mos nuk e kishte biografinë time, të paktën, shpresoja, do e kishte lexuar atë e do të më jepte një dëshmi. Thomai më tha se dikur partia e kishte akuzuar PB për diçka dhe ai nga dëshpërimi ishte hedhur nga ura e lumit Gjanica dhe kishte vdekur. Më erdhi keq për të! Atëherë i thashë të takonim ASH (banonte familjarisht në Patos), i cili kishte qenë zëvendësi i tij në parti dhe kolegu im. Ai ishte personi të cilit ja kishim dorëzuar biografitë ne mësuesit e shkollës së mesme. Thomai më tha se ASH partia e kishte dënuar si armik të saj dhe e kishte internuar (vetëm atë, jo familjen e tij) në një fshat. I kërkova Thomait të shkonim ta takonim e të merrnim prej tij një dëshmi, por Thomai më këshilloi për **jo** duke më thënë

se unë “në vend që të vë vetullat do nxjerr sytë. Si mundet të më besojë patia kur ASh është shpallur armiku i saj!?” Pas kësaj më duhej të dorëzohesha edhe me kërkimin në Patos, dhe n’atë moment mu kujtua (në formë ironike) vargu i poetit “... ku t’i kërkoj rrënjët e tua partil...”

Pas kësaj Thomait i vete mëndja të takojmë Kozma Ristën, një njeri i ndershëm e pozitiv, ish kolegu ynë që ishte marrë në punë nga Komiteti i Partisë në Patos, në zyrën e kuadrit. E takuam dhe tek i tregova arsyen e ardhjes në Patos, Kozmai më pyeti nëse isha larguar për në Tiranë para apo pas dhjetorit 1971. Unë isha larguar në gusht ose shtator 1971. Nga përvoja e tij Kozmai më tregoi se nuk isha i pari në këtë lloj historie me dokumenta dhe pavarësisht se mua nuk më tregohej dosja **mundet** që të kem në dosje dokumenta të humbura, andaj dhe në dhjetor 1971 kishte pas dalë rregullli që në kapakun e dosjeve të shkruhej inventari i saj. Shkurt: “Ti ke ikur pa inventar dokumentash”. Më këshilloi “një formulë” pendese para partisë, nëse do më vinte rasti që ta përdorja, dhe “mos u ndjej sepse partia ka gjithmonë të drejtë.” E falenderova dhe u ktheva në Tiranë për të vazhduar jetën e punën.

Pas disa muajsh, Spiro Baxhaqi, një koleg pune në Krrabë dhe anëtar i ri partie, minoritar babaxhan, më thotë “kam një lajm të mirë për ty. Sekretari i Partisë për minierat e qymyrgurit në Tiranë e ka ndjekur vetë punën tënde deri në instancat më të larta; deri në Byro more!, dhe ti ke dalë i larë fare. Ai do vij vetë në shkollë e do mbledhë kolektivin që të ta thotë para kolektivit. Këtë javë është i zënë e do vij javën tjetër.” Dukej si e habitshme, por Spiro Baxhaqi ishte njeri që nuk fliste kot. Për më tepër “kishte muhabet” me sekretarin e partisë SM. Mirëpo SM vërtet që duhej të kishte pas qënë i zënë me punë: javën që ai do vinte

të sqaronte biografinë time para kolektivit, atë e përjashtuan nga Partia! ... Ku t'i kërkoj rrënjët e tua Parti!?!...

Largimi nga përgjegjësitë drejtuese të shkollës në Krrabë, doli tejet përfitues për mua: në bazë të rregulave të kohës, meqë unë stërvisja një ekip sportistash të kategorisë së parë dhe isha mësues, përfitoja orar të reduktuar në punë. Deri atëherë, për arsye të detyrës, nuk e kisha shfrytëzuar këtë të drejtë. Dhe orari i punës për mua u ndërtua i tillë që në çdo 24 ditë pune (katër javë) shkoja në Krrabë 9 ditë (jepja dhjetë orë mësim në javë dhe drejtoja Komisionin e Lëndëve Matematikë-Fizikë)! Kjo ishte një mrekulli dhe n'atë kohë për disa shkrime që i kisha nisur pata plot kohë që të merresha më shumë me to. Ishte periudha që u dhashë shumë pas ekipit, literaturës pedagogjike dhe sportive dhe kur përvijova disa nga punimet që u botuan më vonë.

Deri nga fundi i viteve 60-të, Komisioni Teknik (KT) merrej shumë me sygjerime që lidheshin me shtrirjen e alpinizmit në Shqipëri, si dhe me organizimin e veprimtarive dimërore e verore. Kurset dyjavore për përgatitjen e alpinistëve të rinj (një në dimër e një në verë), mbeteshin burimet nga ushqeheshin ekipet me alpinistë. Komisioni ndërtonte programe mësimore për këto kurse si dhe përcaktonte drejtuesit e instruktorët (komandantët e togave) në kampet-shkolla ku ushtroheshin alpinistët. Asokohe për këto kampe-shkolla përdorej togfjalëshi "zbor alpinistik".

Më pas, në fund të viteve 60-të por edhe në fillimet e viteve 70-të, rëndësi mori gjetja dhe hapja e zonave të reja për kacavarje në këto kampe-shkolla. Si rregull, në verë alpinistët e rinj shoqëroheshin nga drejtuesit e togave në qendër të fshatit Theth, dhe tek shkëmbijtë aty rrotull kryheshin demonstrime e stërvitje të karakterit kryesisht teknik. Më i parapëlqyer ka



Theth: togë e rreshtuar para nisjes për ushtrim në kacavarje

qenë një shkëmb (një harc) në buzë të rrugës automobilistike, përgjatë anës së rrugës drejt Breg Lum-it. Por erdhi një ditë që aty të “mbahej radhë” për t’u stërvitur.



Harci i Thethit

Në këtë kohë, i propozova Vullnet Zylyftarit që të shkojmë në Okol e të kërkojmë atje shkëmb për stërvitjet e togave që kishim unë dhe ai. Kështu dhe bëmë. Sikundër unë, edhe ai drejtonte një togë alpinistësh. Në Okol, më e përshtatshme doli një masë shkëmbore e madhe në ngjyrë tulle, por e pamjaftueshme në gjërësi për atë që donim. Kjo bëri që të shtyheshim më tej, në zallishtën rrëzë majës së Radohinës. Këtu gjetëm faqe shkëmbore të pafundme në gjërësi e lartësi për atë që donim, madje edhe për kacavarje me shkallë të ndryshme vështirësie. Më pas, ky vend u emërtua “Muri i Radohinës.” Një a dy vjet më vonë, “ndjekja” që na u bë nga territori i Kampit të Punëtorëve (pranë Kroj i Micanve) ku ne organizonim fushimin me tenda, solli që në veprimtaritë verore me alpinistët fillestarët të vendoseshim pranë shkollës së fshatit, tek katarakti (ujvara e Grunasit), si dhe pranë shkëmbijve në qendër të Thethit, në të djathtë të rrugës së makinës tek shkon për në Breg të Lumit.

Fillimisht, klubet sportive kishin një numër të vogël alpinistësh, jo më shumë se tetë. Me rritjen e numërit të alpinistëve në çdo ekip (12 vetë bashkë me trajnerin – norma e ekipit të plotë për çdo klub) si dhe me shtimin e klubeve me ekipe alpinizmi (ky ishte një orientim e zhvillim deri aty nga viti 1971), nevoja për hapësira të reja për veprimtaritë alpinistike u ndje edhe për sezonin dimëror. Kjo u ndje për alpinistët të cilët nuk kishin kategori të larta sportive (d.m.th. kategori të parë sportive e lart). Ata organizoheshin me kampime në qendër të fshatit Bogë, dhe shtrirja e tyre me kampime në Okol të Bogës dhe Ducaj ndeshi në pengesa të llojit **mentalitet** në Komisionin Teknik. Por më së fundi u bë si u bë dhe një vit u la “në dorë të drejtuesve të veprimtarisë për të vendosur.” Kjo thënie “kaloi” si aprovim në Komision. Falë rastit që në veprimtarinë dimërore të



Muri Radohinës

radhës u caktua drejtues Azem Hyka, vendimi i tij për t'u hapur me fushim e ngjitje në Okol të Bogës (edhe përfundimi me sukses i veprimtarisë) e theu ngurimin. Pas kësaj, veprimtaritë me kampime e ngjitje gjatë sezonit dimëror u shtrinë në të gjithë luginën dhe majat përreth saj - nga Ducaj në Fushë të Okolit.

Në fillim të viteve 70-të, me Andon Tapinë Sekretar të Federatës, biseduam dhe si Komision Teknik, vendosëm që të krijojmë/ideojmë kartela personale për të regjistruar ngjitjet e çdo alpinisti. Deri në këtë kohë ngjitjet e realizuara regjistroheshin në një “libër” (regjistër) të madh, që shërbente edhe si arkiv i veprimtarive të Federatës, krejt i ngjashëm sikundër libri ku mbaheshin rekordet e veprimtarive alpinistike deri në vitin



Pamje e pjesëshme e luginës së Bogës në dimër

1965. Madje aty u hodhën edhe ngjitje të alpinistëve ende aktivë dhe që egzistonin në librat e federatës. Me gjasë, Librat e Federatës do ishin krijuar nga koha kur alpinizmi si sport pas L2B ishte përfshirë në sektorin ‘Sportet e Rënda’.

Pra, erdhi dita që ky libër ishte i pa përshtatëshëm për të evidentuar shpejt ngjitjet e çdo alpinisti dhe mbi këtë të përcaktohej kategoria sportive që ai arrinte. Mbasi modeluam dhe prodhuam kartelën, në të filluan të hidheshin ngjitjet e secilit. Kështu, në vitin 1971 e më pas ngjitjet e një alpinisti hidheshin në kartelën e tij personale.

Koha na kishte sjellë nevojën që edhe itinerarët e ngjitjeve që njiheshin, të shënoheshin me ngjyrë në shkëmb si dhe të përshkruheshin me foto e me fjalë. U mendua të krijohej një “katalog” i maleve dhe itinerarëve të ngjitjeve në secilin mal me

Shqiptarë e Turqit dhe Alpinistit

KARTELË PERSONALE E ALPINISTIT

Vendi i ndërtimit: Romeo Manxhari Data: 25.07.1954 Tirane

Kodi: "17 N" Peshë: Mëkharish Agar

Nr.	Vendi i ndërtimit	Data e ndërtimit	Detyra e punës	Maja që ndërti	Parapamje	Sa m.	Sa llogar.	Sa peshë	Kot. e ndërtimit	Vendi i ndërtimit
1			ndërt.	E. Kap					hete	hete
2	Valbonë	ndërt.	ndërt.	Sekonda	(br. 10)				hete	hete
3		1950	ndërt.	Figura					hete	hete
4			alp.	Lugut					hete	hete
5			ndërt.	hete					hete	hete
6			alp.	hete	12				hete	hete
7	Valbonë	ndërt.	ndërt.	Vali	12				hete	hete
8		1950	ndërt.	Vali	12				hete	hete
9			alp.	Zakaria	12				hete	hete
10			alp.	Kopur					hete	hete
11			alp.	Kopur					hete	hete
12			alp.	Vali	12 B				hete	hete
13	Valbonë	1950	ndërt.	Kopur					hete	hete
14			alp.	Kopur					hete	hete
15			alp.	Kopur	12				hete	hete
16	Valbonë	ndërt.	ndërt.	Kopur	12				hete	hete
17		1950	ndërt.	Kopur	12				hete	hete
18			alp.	Kopur	12				hete	hete
19	Provera	1950	ndërt.	Kopur	12				hete	hete
20	Kopur	1950	ndërt.	Kopur	12				hete	hete
21			alp.	Kopur	12				hete	hete
22			ndërt.	Kopur	12				hete	hete
23			ndërt.	Kopur	12				hete	hete
24	Kopur	ndërt.	alp.	Kopur	12				hete	hete
25		1950	ndërt.	Kopur	12				hete	hete
26			ndërt.	Kopur	12				hete	hete
27			alp.	Kopur	12				hete	hete
28			ndërt.	Kopur	12				hete	hete
29			ndërt.	Kopur	12				hete	hete

Kartelat nr 3 e Romeo Manxharit

si pjesëmarrësin kryesor në këtë nismë, dhe fill pas meje do rendisja Qazim Liçon e Taxhedin Shehun. Shënimi me ngjyrë i itinerarëve të kacavarjes në pikat ku ata fillonin u vlejti si orientim alpinistëve kacavarës për të shkuar në itinerarët me kategori të

caktuar vështirësie si dhe për organizimin dhe shpërndarjen e ngjitësve në zonat e veprimtarive.

Kartela për regjistrimin e ngjitjeve të alpinistit ishte e domosdoshme për kohën dhe vlejti për të patur rekorde (shënime) për veprimtaritë e alpinistit si dhe lehtësi për të nxjerrë kategorinë sportive të arritur. Kategorizimi i alpinistëve n'atë kohë lidhej me përfitime të tilla si: orar i thjeshtuar në punë (pesë orë punë) dhe trajtim ushqimor. Këto përfitime për ca kohë herë jepeshin e herë hiqeshin nga shteti; herë shtoheshin e herë thjeshtoheshin, në vartësi se si formuloheshin shkresat, e lidhur kjo, besoj, edhe me buxhetin shtetëror për sportin.

Përvoja e Anton Tapisë në Çekosllovakia nuk e bëri dysh idenë e ndërtimit të një udhëzuesi (katalogu) për itinerarët e mundëshëm të ngjitjeve në Bjeshkët e Namuna e në malet kryesore të vendit ku ne kryenim veprimtari alpinistike. Për këtë filloi fotografimi i itinerarëve dhe Zenel Kokomiri e Mit'hat Fagu ishin fotografët, njëherësh alpinistë, që punuan në këtë drejtim. Zyra e Federatës sonë "u mbush" me fotografitë e bëra. Unë mora përsipër të filloja menjëherë nga puna për realizimin e idesë, dhe si zonë të parë për udhëzuesin, që do të prodhonim/botonim, zgjodha itinerarët e ngjitjeve në Majën e Shtegut, majat Binjake përballë tij (i quanim Mark e Zagorë), si dhe faqen shkëmbore "Muri i Radohinës". Këto zona edhe sot i çmoj si ideale për ushtrimin e kacavarjes shkëmbore nga alpinistë të cilët i kanë mësuar elementët e saj. Zona e Shtegut të Dhenve ka problem ujin mbas datës 15-20 Korrik. E ëndërroja që këtu të ngrihej Shkolla Shqiptare e Alpinizmit mbasi me një marshim të përballueshëm nga Boga, në rastet e bllokimit të rrugës automobilistike nga bora, është vend i arritshëm edhe në dimër.



Mit'hat Fagu



Një kujtim me Zenel Kokomiri


Më pas modelova një përshkrues (formular) të ngjitjes së itinerarit të vlefshëm si për kacavarje edhe për ngjitje dimërore. Në të kërkohej që çdo grup që realizonte një itinerar, ta përshkruante atë mbi bazën e një standardi kërkesash për të cilat trajnierët e ekipeve morën udhëzime të veçanta në një nga seminarët kualifikuese që organizoheshin. Ideja e këtyre përshkrimeve ishte që ato të grupoheshin sipas maleve dhe mbi këtë lëndë të ndërtohej udhëzuesi i itinerarëve të ngjitjes për çdo mal që kishte vlera alpinistike.

Mirëpo ideja për ndërtimin e udhëzuesit ngeci për kohë apo orë pune dhe mjete financiare. Duhej që të paktën një person të merrej me të. Por tek e fundit, e gjithë ajo fillesë entuziaste përfundoi me një “libër bllok”, ku u vendosën fotot e zonës së Shtegut të Dhenve të ngjitura në të me

zona e Shtegut dhe përdorej, por pas dy tre vitesh këtë libër dikush e zhduk.

Kur rifillova pjesëmarrjen (anëtarësinë) në Komisionin Teknik të Alpinizmit, ishte koha që pasja e një programi unik të stërvitjes së ekipeve të alpinizmit ishte bërë domosdoshmëri, madje kërkesa ishte për të gjitha llojet e sporteve. Sipas kërkesës që i kishin bërë, Mario Trinkera kishte marrë përsipër dhe kishte përgatitur një gjë të tillë, por ai material nuk i përgjigjej kohës as edhe kur doli nga shtypi sepse Komiteti Shtetëror për Kulturën Fizike dhe Sportet nxorri për të gjitha sportet kërkesa edhe më të përparuara për programin stërvitor.

Po flitej gjithnjë e më shumë në të gjitha sportet, për të patur diçka që t'i përgjigjej sa më mirë kërkesës së kohës për cilësi sportive. Unë paraqita në KT programin stërvitor që përdorja për ekipin dhe u ra në ujdi që ta shumëfishonim në mënyrë të




Programi unik i stërvitjes me autor Mario Trinkera

thjeshtë e ta përdornim përkohësisht edhe për ekipet e tjera. Në të njëjtën kohë i hyra seriozisht punës për të bërë një program unik të stërvitjes së ekipeve të alpinistëve. Mora në konsideratë atë pak gjë që ekzistonte në Bibliotekën Kombëtare për stërvitjen e alpinistit - literaturë në gjuhën ruse, si dhe atë që ishte botuar për sportet e tjera në shqip. Gjeta në bibliotekë edhe literaturë rumune (një libër, botim i viteve 70-të) nga i cili mora shenjat konvencionale (legjendën) që përshkruanin relievin për një kacavarës. Bisedat e mia me Arben Jorgonin lidheshin shpesh me temat e stërvitjes dhe ishin dobiprurëse për mua. Mbi këtë bazë ndërtova një program të ri stërvitor për ekipin tim për vitin 1980 dhe mbi këtë përvojë të re ripunova programin për vitin 1981. Ky i fundit shërbeu si material bazë me të cilin përgatita punimin “Stërvitje e Ekipeve të Alpinizmit”, Program Unik i Stërvitjes së Ekipeve të Alpinizmit për të Rritur, që u aprovua nga Federata dhe doli i shtypur nga Shtypshkronja e Dispencave Tiranë më 1982. Ky botim si dhe botimi “Alpinizëm” me bashkëautor Kozma Grillon, mendoj se janë dy arritje të mëdha të alpinizmit tonë në drejtim të literaturës, dhe kam bindjen se edhe sot mund të përdoren si materiale bazë për një shkollë alpinizmi.

Në vazhdim të programeve unike stërvitore, pas një viti përgatita një të tillë për ekipet e të rinjve që iu përcoll trajnerëve nëpërmjet leksioneve në një seminar; dhe më pas përgatita një tjetër për ekipet e pionierëve; edhe ky iu përcoll trajnerëve me leksione në seminar. Të dy këto materiale u shumëfishuan me shaptilograf.

Përvoja e fituar që nga koha që kisha punuar në Fier më pat bindur se isha në gjendje të ndërtoja ekip të mirë, por puna është se alpinizmi nuk është veprimtari kolektive vetëm brënda ekipit.



Programi unik i stërvitjes me autor Aleksandër Bojaxhi

Në shumë mënyra jeta sportive e një ekipi ndërlidhet edhe me individë edhe me ekipe të tjera. Që të mos mbetesh i “ditur i veçar” duhet të ndihmosh edhe të tjerët që të bëhen të ditur. Ky është një mesazh i përditshëm që të ri në mëndje nëse merresh me edukimin dhe me mësimin e të tjerëve (profesioni që kisha), me një kusht: të mos e konsiderosh vehten mësues të “lëndës” por para së gjithash mësues të nxënësit, pavarësisht nëse ky është nxënës në një shkollë të mirëfilltë apo anëtar i një ekipi sportiv. Siç duket, sa më sipër do të ketë qënë një nga shtytat kryesore që më ka bërë t’i përtyp e ripërtyp ato që më ka mësuar jeta dhe literatura - përvojën dhe dijet e fituara - dhe t’i nxjerr, shkruaj e botoj në një formë që të jetë e pranueshme dhe e kuptueshme për të tjerët. Kjo bëri që të lexoj gjithshka që kishte Biblioteka Kombëtare në Tiranë në lidhje me sportin e alpinizmit. E kam quajtur veten “alpinisti trajner” sepse kur e fillova këtë sport nuk kishte trajnerë për të (kishte instruktorë) dhe nga gjithshka

që lexova dhe synova, distilova ato që më duheshin dhe më pas ato u provuan dhe u përjetuan fillimisht me mua si dhe me ekipin dhe më pas u përcoll tek të tjerët nëpërmjet seminareve kombëtare, në botimet e kryera dhe temat e referuara, si dhe vazhdimisht në mendimet e përcjella në KT.

Erdhi një ditë, dhe KT krijoi botimin e përvitshëm ‘Rregullore e Brendshme e Alpinizmit’. Fillimisht, këtu vendosëm disa udhëzime lidhur me rregullat e sigurimit në mal, kalendarin e veprimtarive vjetore, etj. Kur u hoqën kurset e përgatitjes së alpinistëve fillestarë – shkollat e alpinizmit apo zboret alpinistike - (tashmë supozohej se shkolla realizohej nëpërmjet stërvitjes në ekip), në kalendarin e veprimtarive u caktuan vetëm veprimtari me alpinistë të “kategorive të ulta” (me alpinistë të kategorisë së tretë dhe të dytë sportive; jo më me alpinistë fillestarë) dhe me alpinistë të “kualifikuar” (me ata që kishin kategori sportive të parë e lart). Tashma, mangësitë e përgatitjes së alpinistëve në



Rregullore e Alpinizmit
për vitin 1980

rrethe dolën në pah gjatë veprimtarive. Në këtë kohë, botimi i “hollë” *Rregullore e Brendshme e Alpinizmit* erdhi dhe u trash; dhe ky buletin mori rolin e “rojes” me rregulla të tepruara deri në formulime të tilla si: “alpinisti duhet të vijë në mal me kazmë; ekipi duhet të ketë kaq e aq karabina, plenga, litarë”, etj.

Fakti që sporti ynë nuk kishte një revistë ku të shkruhej për alpinizmin, bëri që nga broshura e rregullores të kalohej në një buletin në të cilin hidheshin të gjitha ngjitjet që kryenin ekipet, rregullorja, etj., etj.; si dhe gjithçka që ne si KT e aprovonim që të referohej në seminare. Që buletini të botohej nuk ishte gjë e lehtë. Fillimisht ndihmoi dhe drejtoi punën Minella Kapo, por dikur erdhi një moment që puna e daljes së tij të ngeci për mungesë herë të mundësive intelektuale e herë të mundësive në kohë.

KT kishte detyrë të organizonte edhe seminare kualifikimi për trajnerët. Në to shpesh kishte materiale interesante, por me shtimin e propagandës nga partia në pushtet për arritjet e saj, erdhi një kohë dhe na dolën njerëz që donin të referonin, dhe referonin, vetëm për fitoret e Partisë së Punës dhe “përfitimet” nga leximi i materialeve të Partisë para fillimit të stërvitjes së ekipit!

Që të isha në vijë me kërkesat e partisë në programin stëvitor futa termin “Punim i një materiali të Partisë”. Personalisht një herë në javë, më të shumtën e herës bëja një “Informacion politik” në krye të stërvitjes, në klasën në dhomën e stërvitjes që krijuam. Edhe në seminare, nuk mundej të përfytyroje që ai do realizohej pa treguar meritat e Partisë. Kam ruajtur disa referime të miat dhe do mundohem të gjej kohë që t’i botoj, në mënyrë që brezat e ardhëm të dinë se si kemi punuar. Si kudo në jetën tonë të asaj kohe, fillimet e një referimi kishin një përshkrim të

arritjeve tona “nën kujdesin e partisë”, nën “direktivat e aksh Kongresi”, nën “mësimet nga shoku Enver” etj si këto. Por kishte nga ato referime që nuk kishin fare sport brenda. Dhe eja e mos t’i aporvonte KT ato “tema” si tema që duhej të referoheshin në seminar! Personalisht në temat e mia kam pas një **hyrje** si më sipër por kam pas më tej vetëm përpunim të literaturës që lidhej me alpinizmin, madje edhe me turizmin; natyrisht edhe me përvojën time dhe të ekipit. Për mendimin tim, ndër seminarët e organizuara, mbresëlënës kanë qenë - ai që u organizua për të parën herë në Korçë me vend tubimesh teorike në mjediset e Kabinetit Pedagogjik, ai i Vlorës në vitin kur ne na strehuan tek kampi i puntorëve, dy të organizuar në malin e Dajtit dhe ai i Tiranës me bazë ekipin e alpinistëve të 17 Nëntorit në vitin 1987.

Kategoritë sportive

KT ishte një hallkë e Federatës dhe kur alpinistët arrinin norma të caktuara nëpër veprimtari kombëtare (plotësonin kritere të caktuara të tabelës së klasifikimit unik për alpinizmin), u shpallte arritjet në kategori sportive deri tek titulli “Kandidat Mjeshtër Sporti”, si dhe hallka që i propozonte Kryesisë emrat për Mjeshtër Sporti kur këta plotësonin kërkesat. Ky ishte rregulli, por që shpesh nuk ndiqej **për titujt** (të cilët u dhanë edhe pa i plotësuar normat, por dhe nuk u dhanë, me raste, kur ishin plotësuar normat).

Meqë kategoritë sportive të alpinistëve lidheshin me përfitime në orar pune të reduktuar dhe trajtim ushqimor, kujdesi që të mos “futeshin duart” në kartela ishte bërë i madh. Gjatë kohës që isha i përjashtuar nga KT, duart ishin futur (jo,

aspak, ngaqë nuk isha anëtar) në kartelat dhe këtë e kishte pas konstatuar Minella Kapo, i cili për një periudhë kohe ishte Kryetar i KT. Andaj ai i kishte pas marrë kartelat nga zyra e Federatës dhe i kishte sistemuar në zyrën e tij (Sektori Shkencor në Institutin e Kulturës Fizike “Vojo Kushi” – sot Universiteti i Sporteve). Kur u rikthevea në KT, Minella më afroji të bashkëpunonim dhe vetëm unë dhe ai merreshim me kartelat. Ai i mbajti ato për një kohë të gjatë në zyrën e tij, por një ditë i hoqi nga vetja. Edhe diçka që duhet të dihet:

Kur bashkëpunoja me Minella Kapon për kartelat, një ditë ne i ndamë ato në dy pjesë: ato të alpinistëve që nuk ishin më aktivë (këto i paketuam për në arkiv) dhe kartelat e alpinistëve që ishin qoftë edhe minimalisht aktivë. Pasi Minella u tërhoq nga puna në KT, Kryetar i Komisionit Teknik u caktua Kozma Grillo. Kartelat u kthyen në Federatë. Unë punoja në zyrën e Federatës me to, por në fund të vitit 1989 vendosa të tërhiqem nga puna me kartelat në Komisionin Teknik.

Në vitin 2015 Kozma Grillo më dorëzoi kartelat e alpinistëve. Ai ishte tërhequr prej kohe nga komunikimet dhe bashkëpunimi me Federatën dhe kartelat i kishte marrë në ruajtje. Meqë erdhën kohë që “nuk bëhej më alpinizëm” ai i mori në shtëpi kartelat që të luante rolin e “arkivit” për këtë pjesë të kujtesë të lëvizjes alpinistike. Sigurisht duke menduar që t’i mbajë ato, deri në ditën kur Federata jonë të ishte bindëse se do kujdeset për historinë e këtij sporti. Kur i mora i shqyrtova ato. Është për të ardhur keq që aty mungonin kartela dhe më e keqja është se aty mungonin kartelat e ekipeve “Studenti” dhe “Skëndërbeu”, ekipe që kanë patur peshë në këtë sport.

Sikundër shënova më sipër, kur alpinistëve iu hapën kartelat e arritjeve, në to shënoheshin ngjitjet e realizuara nga ta me

pushtimin e majës së malit, por dhe ato të pa realizuara me ngjitjen e majës. Kështu, dhënia e kategorive sportive u stabilizua dhe kategoria merrej nëse plotësoheshin normat që kishte tabela e klasifikimit unik sportiv për sportin e alpinizmit. Ndërkohë që me kategoritë sportive puna erdhi dhe u stabilizua, kjo nuk ishte kështu për titullin Mjeshtër Sporti. Do të sjell si ilustrim rastet si më poshtë të cilat përfaqësojnë të përgjithëshmen e kohës.

a. Një ditë, ndërsa po punonim me Minella Kapon për nxjerrjen/llogaritjen e kategorive pas veprimtarive të një sezoni ngjitjesh, ai më tregon se **ishte i penduar që nuk i kishte dhënë** titullin Mjeshtër Sporti Vasil Vretos. Sipas tij, ai nuk ia kishte dhënë atëhere kur duhej titullin Mjeshtër Sporti Vasilit ngase mendonte se pas dhënies së titullit Vasili do të largohej nga veprimtaritë alpinistike, kurse me mosdhënien e titullit mendonte që do ta mbante atë pjesëmarrës në veprimtari. Mirëpo Vasili, sikundër i rodhën ngjarjet me punën e me jetën, filloi të vinte gjithnjë e më pak në veprimtaritë alpinistike deri sa një ditë ai u shkëput fare nga alpinizmi. Vitet kaluan dhe për Minellën nuk kishte më kuptim që t'i jepej titulli pas një vakumi sportiv. Theksoj këtu, se titulli **nuk iu dha** Vasilit.

Për rastin tim them se mua **m'u dha** titulli Mjeshtër Sporti. E kam pas parë tabelën e kërkesave pasi u propozova për titullin dhe rezultonte se n'atë kohë unë isha me mangësi në numrin e ngjitjeve që duhej të kisha në veprimtaritë dimërore. Pra ishte një 'traditë' e heshtur që titulli **jepej** kur krijohej bindja se ishe alpinist me vlera, dhe se dikush aty "lart" e aprovonte. Por njëherësh kjo nuk domethënë se tabela nuk shihej, por domethënë se ajo nuk shihej me rigorozitetin që duhej dhe kjo, si për titullin Mjeshtër Sporti ashtu edhe fillimisht për kategoritë sportive. Është me

vend të theksoj që shpesh vlente edhe opinionin pozitiv që kishte arritur një alpinist në veprimtaritë e zhvilluara. Me hapjen e kartelave për çdo alpinist, dhënia e kategorisë erdhi nga viti në vit duke u stabilizuar - dhe u stabilizua. Kam bindjen se duke filluar nga viti 1978 kategoria sportive e alpinistit jepej vetëm sipas klasifikimit unik sportiv për sportin tonë.

b. Por ndërsa dhënia e kategorive sportive erdhi dhe u stabilizua, nuk ndodhi kështu me titullin Mjeshtër Sporti. Për ilustrim, po sjell rastin e ekipit të Tiranës të cilin e drejtova gjatë 21 vjetëve.

Nga viti 1970 e më tej, kur diskutohej në KT për titullin Mjeshtër Sporti, alpinistët më të njohur nga kryeqyteti për këtë titull ishin Qazim Liço dhe Kristaq Korçari. Në KT këta emra nuk u aprovuan kurrë. Rasti i fundit që u diskutua emri i Kristaq Korçarit, ishte kur u diskutua për këtë titull alpinisti Koço Ziso i Korçës. Koço “kaloi” me justifikimin se ‘Korça nuk ka asnjë Mjeshtër Sporti në Alpinizëm’, kurse Kristaqi nuk “kaloi” sepse “ekipi 17 Nëntori ka mjeshtër”; ndërsa Qazim Liço (K S Partizani) nuk u përmënd më për titull.

c. Më 1972 ose 1973, O i jepet titulli Mjeshtër Sporti. Nuk u kuptua kurrë se si ndodhi, as nga ekipi e as nga Klubi. Madje ekipi e mori vesh me vonesë që O kishte këtë titull, megjithëse formalisht vazhdonte të egzistonte, dhe egzistoi, edhe më tej në rregjistrin e ekipit prej disa vitesh si inaktiv, sepse nuk vinte as në stërvitje e as në veprimtari (flas për periudhën shkurt 1968 - shkurt 1974). U desh të vinte shkurti i vitit 2009 që Andon Tapia të më tregonte historinë e dhënies së këtij titullit. Andoni ishte Sekretar i Federatës në ato vite. Ai më tregoi se “O më ngeli mbas derës dhe më kërkonte titullin. M’u mërzit, dhe një ditë i kërkova të bënim një ujdi: Unë t’i jap titullin kurse ai të

më bëjë propagandë. Mirëpo ndodhi që unë i dhashë titullin dhe ai nuk më bëri propagandën.”

d. Ndoshta në kohën kur sapo isha rikthyer si anëtar në KT, më thërret në zyrë Shefi i Klubit tonë Muharrem Sinoimeri. Më kërkon që të interesohesha dhe ta informoja se si është qëndrimi moral e familjar i Mario Trinkerës. Shefit dikush ia kishte nxirë atë njeri! Mario kishte patur probleme me gruan e parë që unë nuk i di, por me të dytën ai kishte një familje model (unë hyja e delja në shtëpinë e tij sikundër edhe në ato të anëtarëve të tjerë të ekipit) dhe për ne në ekip ai nuk ishte njeri me probleme morale. Arësyeja që më thirri Shefi i Klubit ishte se Mario, në bazë të arritjeve që kishte realizuar, kishte marrë vetë nismën për të kërkuar që t'i jepej titulli Mjeshtër Sporti. Dhe ai e mori këtë titull duke i filluar procedura nga klubi sportiv ku ai bënte pjesë.

e. Në fillim të viteve 80-të, pasi kryen edhe ngjitjen në itinerarin veri-lindor të majës së Harapit, Romeo Manxhari plotësoi kërkesat për titullin Mjeshtër Sporti. Menjëherë pas tij i plotësojnë kushtet edhe Sokol Doko e Ilir Tapia. Tri herë janë bërë dokumentat e tyre (kërkesa) sipas rregullave që kërkonte koha nga Klubi 17 Nëntori; një herë i kam dërguar vetë dokumentat nga Klubi (që bënte edhe kërkesën) për në zyrën e Komitetit të Fiskulturës së Tiranës, e cila ia kalonte zyrtarisht Federatës. Këta nuk e morën kurrë këtë titull. Dhe këta si alpinistë nuk ishin kushdoi! Nëse kacavarja tek ne pati një kulm deri në fillim të viteve 90-të, mendoj se ndër 3-4 alpinistët që duheshin vlerësuar si më rezultativë ishin Iliri e Sokoli. Në vitet 80-të pati dy raste që alpinistë të ekipeve të tjera ngelën në shkëmb dhe ishin në rrezik të humbisnin jetën. Në të dy rastet ishin Ilir Tapia e Sokol Doko që u thirrën dhe vajtën e i nxorën njerëzit nga rreziku. Dhe këto ndodhi i dinte lëvizja alpinistike,

i dinte kushdo në KT dhe në Kryesinë e Federatës së Alpinizmit. Më pas, KT aprovoi emra të tjerë për titullin Mjeshtër Sporti, individë të cilët **nuk** i kishin plotësuar kërkesat, por jo këta që kishin plotësuar kërkesat. Kurrë nuk e mora vesh se ku ngecte e drejta e tyre. Nëse në kohën kur ma dhanë mua titullin vura re se kishte moral dhe opinion që ishte krijuar gjatë veprimtarive për mua dhe që ta vlerësonin të tjerët, tashmë nuk ishte fare kështu. Sekush mendonte për veten a për klubin pa ia ditur për moral e klasifikim unik sportiv. Kjo bëri që një ditë (edhe sot e kësaj dite) nuk e përdora më titullin Mjeshtër Sporti si më parë, në rastet kur e përdorja.

Në kohën kur enverizmi po binte, u hapën edhe mundësitë për të dalë jashtë vendit në veprimtari “ndërkombëtare.” Mbjaj mend që mbledhjet e kësaj kohe në KT ishin hera-herës me “brryla.” Shumëkush nga gjenerata më e vjetër e alpinistëve kishte dëshirë të dilte jashtë shtetit (sigurisht jo për sport, por besoj për mundësi sado të pakta për të ngritur nivelin e ekonomisë familjare), dhe e ndiente të arësyeshme që Federata dhe KT ta përfillte në listë për veprimtari ndërkombëtare. Ndonëse alpinizmi është një sport ku nuk ka individ apo ekip kampion, dikush filloi të mburrej me zë të lartë se ‘kishte ekipin më të mirë të vendit tonë’, dikush që ‘kishte patur vlera dhe kishte dhënë e sakrifikuar shumë për alpinizmin’, etj. Personalisht opinione të tilla unë ia shprehja vetëm vetes, si për ekipin edhe për individë të veçantë të tij. Pas një a dy mbledhjesh të kësaj kohe - kulmi arriti atëherë kur erdhi një ftesë për të dërguar një ekip në Rumani - një ndiesi e brendshme që të mos shikoja se si shokët e mi, alpinistë e njerëz të mirë ndër vite, në kushte të shoqërisë që në kufijtë e varfërisë ekonomike po shkërmoqte tabutë politike, do të nxirrnin në pah pjesë të heshtura të vetes



Ekipi i alpinistëve 17 Nëntori në shkurt 1981 në majën e Brijasit
(Fotografoi Aleksandër Bojaxhi)

me egot e tyre të lexueshme e të palexueshme në argumentimet për të dalë “jashtë shtetit”, më shtynte të qëndroja larg KT. Dalja jashtë shtetit ishte “fitim tenderi” n’atë kohë. Të vazhdoja të qëndroja në mbledhjet e KT ishte si të hapja një mollë të kuqe e të bukur, që e ndijesojta të tillë prej gati tri dekadash, e të shihja se çfarë krimbash kishte ajo brënda. U tërhoqa nga mbledhjet e KT në fund të vitit 1989, por jo nga takimet jashtë mbledhjeve apo me drejtuesin e Federatës sonë.

Ndërkohë edhe veprimtaritë alpinistike po vdisnin. Në verën e vitit 1991, ekipi ynë arriti në Theth, vendi ku ishte caktuar për veprimtarinë verore të ngjitjeve të kualifikuara. Ishte viti që edhe im bir, Gjergji, kishte fituar të drejtën të merrte pjesë në këto ngjitje. Në Theth nuk erdhi asnjë ekip. Të vetëm sikundër mbetëm, vendosëm të sodisim luginën e Thethit. E shkelëm dhe

e pamë atë që nga Kapreja magjepse e deri në majën e Jezerës, kulmin e Alpeve tona.

Që në vitin 1964 ishte “vulosur” përfundimisht bindja që zona më alpine e vendit tonë është Shqipëria Veriore. Poligonet e veprimtarive alpinistike janë kryesisht Alpet Shqiptare apo Bjeshkët e Namuna. Porse, ndoshta një ndikim psikologjik i një populli ku partia që e udhëhiqte kishte shpallur për qytetarët e saj se “Detyrë mbi detyrat është mbrojtja e Atdheut”, bëri që KT të futet në një psikoze që nuk kishte synim cilësinë sportive. Na erdhi në KT kërkesa që edhe në malet e jugut të vendit tonë të kishte veprimtari **edhe më të shumta** nga sa realizoheshin atëherë. Më kujtohen diskutime të llojit se “atje ku futemi ne, nuk futet armiku”; “atje ku ngjitemi ne, nuk e pret armiku”, etj. Sigurisht që nuk mund të thojë në këto mbledhje se armiku që do na pushtojë nuk vjen për të pushtuar majat e maleve, por duhej bërë diçka në këtë situatë. Rezultati: u ideua një ngjitje me nisje nga Poliçani me itinerar: Teqeja e Kulmakut, Zaloshnjë, Gjerbës, Qafë-Martë, Vithkuq, Korçë. Gjatë këtij marshimi ngjteshin: Maja e Kulmakut (ndryshe Çuka Partizan), Maja e Zaloshnjës dhe maja e Ostrovicës. Më 1974 (besoj se jam i saktë) mora pjesë edhe unë, bashkë me një ekip të klubit tim, në këtë lloj veprimtarie. Arrita në përfundimin se ishte një volum fizik i madh dhe si cilësi sportive kishte vetëm ngjitjen e majës së Ostrovicës. Në KT bëra argumentimin për të mos e organizuar më këtë veprimtari dhe pati njëzëshmëri që kjo veprimtari të hiqej nga kalendari sportiv për vitet në vijim.

Në sistemin enverist çdo gjë duhej të ishte nën kontroll (e kontrolluar). Kështu edhe veprimtaritë alpinistike. Në opinionin tim, që prej viteve 50-të kjo kishte krijuar mendësinë që mundësisht të gjithë alpinistët (ekipet) të bëheshin bashkë

dhe të realizonin veprimtarinë në një dritare kohore të vetme. Porse, veçanërisht në stinën dimërore, ishte e vështirë që ta realizoje. Duke qenë shpesh drejtues i veprimtarisë e shikoja se grupi fillestar që mblidhej për të ndërmarrë realizimin e ngjites “hollohej” sepse dikush nuk kishte përgatitjen e duhur fizike, dikush ngaqë nuk kishte ushqime të mjaftueshme, etj arësye. Ekipet kishin trajnerë të ndryshëm, bazë materiale jo të barabartë (klubet sportive financiarisht nuk trajtoheshin si të barabartë në raport me spotistët që kishin). Që në nisje nga qytetet e tyre, pra pa arritur në vendin ku organizohej veprimtaria, dihej që ekipet ishin me disnivele. Dhe duhej që si drejtues të realizoje të njejtën veprimtari për secilin ekip pjesëmarrës! Ishte absurde! Por pas një viti me diskutime të herë-pas-herëshme arritëm unanimisht në idenë që të krijojmë disa grupime me vetëm 2-3 ekiye bashkë për të ndërmarrë veprimtarinë e radhës. Madje kush mundëte nga ne anëtarët e KT e formonte gjatë mbledhjes grupimin sipas dëshirës. Kjo ishte më mirë se më parë. Grupimet e vogla rritën përgjegjësinë për tu përgatitur/stërvitur për veprimtarinë.

N’ato vite, parashikimi i motit ishte larg saktësisë me të cilën parashikohet sot. Duke caktuar një dritare me data fikse, pati raste që e gjithë veprimtaria dimërore e FSH të Alpinizmit të dështonte. Kjo solli nevojën që të krijoheshin grupime ekipesh të cilat niseshin për në mal në dritare ditësh të ndryshme. Ky lloj organizimi dha si rezultat shtimin e numërit të majave të ngjitura në sezonin dimëror krahasuar me vitet e mëparshme.

Nga përvoja e ngjitjeve dimërore kisha arritur në përfundimin se fillimi i muajit shkurt është koha më e mirë për ngjitjet dimërore në vendin tonë. Kjo jo vetëm se ky muaj është “zemra” e dimrit tek ne, por edhe sepse kur lëviznim kampet nga një vend në tjetrin, ky muaj të mundëson (në lartësitë e kreshtave)

që të udhëtosh deri në orën 17:00, dhe pastaj të ndalesh edhe për një orë me dritë e muzg të ngresh/ndërtosh kampin e ri. Me shokë të stërvitur arrin të bësh gjithshka që duhet për të kaluar natën brenda një ore, dhe kur fillon shkrirja e borës për të siguruar ujin e pijshëm gjithkush është i sistemuar në tendë.

Gjatë viteve kam kryer dy hulumtime:

Kam hulumtuar të gjitha organet e shtypit, për periudhën 1960 deri 1974, për të mësuar se sa propagandë u është bërë argëtimeve në natyrë (alpinizëm dhe turizëm malor). Rezultoi se propaganda më e dëndur në shtyp është bërë në periudhën 1964-1970.

Kam hulumtuar për aksidentet në alpinizëm dhe i kam referuar në temën “Disa të Papëlqyera në Sportin e Alpinizmit”. Tema përfshiu hulumtime që nga vitet 50-të e deri në vitin 1980. Materiali u referua në seminarin e dhjetorit 1981.

Hulumtimet u realizuan nëpërmjet komunikimeve direkte si dhe me korespondencë me letra. Kjo sepse në atë kohë telefoni nuk i mundësohej kujtdo. Po ashtu komunikacioni me automjete ishte i mundimshëm. Nga hulumtimi rezultoi se kishin ndodhur 47 aksidente (të papritura). Studimi tregoi se ato ishin pasojë e 18 shkaqeve që i sollën. Nga studimi rezultoi se 29 aksidente lidheshin me një shkak, 12 aksidente lidheshin me dy shkaqe dhe 6 aksidente lidheshin me tre shkaqe.

Mendoj se sa më sipër vlejné për t’i ditur brezat e alpinistëve pas brezit tim, si dhe një historiani të sporteve. Kujtoj se ana shpirtërore e alpinizmit mungon në këto rrjeshta. Sa më sipër më duken si punët e “zyrës”, si teknikalitete. Përjetimet gjatë veprimtarive kanë patur bukuri sublime dhe duhen faqe të tjera për t’i shkruar. Por, për të mos i lënë këto shënime pa shpirt dua të përmbyll kujtimet e mësipërme thënë se në jetën time, për

fat kur sapo i kisha kaluar vetëm 18 vite jetë, njoha edhe malet duke kaluar nëpër to si alpinist me kazmë alpine dhe litar. Nëpër lugina dhe në lartësitë e maleve gjeta skulpturat e përkryera të natyrës, kopshtet oaze të shlodhjes, përjetova madhështinë e arritjeve, shoqërinë Besoj dhe uroj se një herë tjetër do të shkruaj për të gjitha këto!

Aleksandër Bojaxhi

Nëntor 2021

